

# Formësojmë të **ARDHMEN**

**Raporti Vjetor 2020 / Grupi SIGAL UNIQA**

*Annual Report 2020 / SIGAL UNIQA Group*

# PËRMBAJTJA

## FJALA PËRSHËNDETËSE

Z. Andreas BRANDSTETTER,  
CEO i UNIQA Insurance Group

Z. Avni PONARI,

CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

## KUSH JEMI NE?

- Parimet dhe vlerat tona
- Çfarë kërkojmë të jemi
- Çfarë është e rëndësishme për ne
- Ne jemi "SIGAL"
- Kush është "UNIQA"?

## PERFORMANCA NË 2020

- Ngjarjet kryesore 2020
- Marketingu
- Qendra e Asistenës 24/7, Faqe e Dedikuar për Covid-19 & Përsheptimi i Praktikave të Dëmeve
- Media
- Përgjegjësia sociale në sport, art, kulturë, edukim dhe punësim
- Produktet dhe shërbimet më gjithëpërfshirëse, më tërheqëse dhe më novatore
- Inovacionet dhe shërbimet e reja dixhitale online

## TREGU RAJONAL I SIGURIMEVE

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

## RAPORTI I AUDITUESIT TË BRENDSHËM

## PARIMET E MENAXHIMIT TË RISKUT

## OBJEKTIVAT

## KONTAKTE

# Pararojë e zhvillimit! Formësojmë të ardhmen!



Drejtoria e Përgjithshme  
Tiranë, Shqipëri

*Të dashur lexues,  
Të dashur zonja dhe zotërinj,  
Të dashur aksionerë,*

**NE formësojmë dhe mbrojmë të ardhmen:** Këtu, tek SIGAL UNIQA, ne kemi shkuar përtej zgjidhjeve tradicionale të ofruara nga biznesi i sigurimeve: në vend nga transferimi i rreziqeve drejt ofrimit të produkteve dhe shërbimeve për parandalimin e tyre.

**NE jemi të përgatitur dhe gati.** Ngjarjet e vitit 2020, veçanërisht pandemia COVID-19 dhe më tej pas-tërmetet e 2019, theksuan më shumë sesa kurrë më parë vlerën e përgjithshme dhe të shtuar të parapërgatitjes. Ne treguam se ishim gati dhe të aftë që të tranzitonim me sukses në një botë të re – një epokë tërësisht dixhitale. Dhe këtë herë ne u testuam edhe vetë. Në fillim të vitit 2020 ne nuk e dinim se ishim në kulmin e shpërthimit të një pandemie globale, por ne ishim gati.

**NE jemi dinamik, të zhdërvjellët dhe të ekuilibruar:** Me rreth 1,700 punonjës dhe partnerë ekskluzivë shitjesh, ne ofrojmë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Klientët tanë përfshijnë individët, bizneset e vogla, sipërmarrjet e mesme dhe të mëdha, si edhe kompanitë ndërkombëtare të cilat operojnë në vend, etj.

**NE jemi një prani rajonale e konsoliduar dhe solide:** Ne jo vetëm që jemi lider të tregut vendas, por ne zotërojmë një pozicion solid edhe në rajon si sigurues i besuar dhe i përgjegjshëm në mbështetje të aktiviteteve të individëve, operacioneve tregtare dhe klientëve të sipërmarrjeve dhe kompanive të vogla, të mesme dhe të mëdha.

**NE nuk ndalemi kurrë.** Ne kemi përsheptuar transformimin dhe progresin tonë teknologjik, duke adoptuar teknologjitë dhe inovacionet më të reja, më të shpejta, si edhe duke përvetësuar dhe fituar aftësi të reja dhe mënyrat e reja të punës nga të gjitha forcat tona të punës.

**NE jemi gjithmonë në rrugën e duhur.** Në vitin 2020, si pjesë e Grupit të Sigurimeve UNIQA, gjigandi financiar i sigurimeve në Austri dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore, dhe në kuadër të programit të ri strategjik "UNIQA 3.0 – Farkëtojmë të ardhmen", SIGAL UNIQA filloi një cikël të ri strategjik 10-vjeçar. Në përgjigje të sfidave të shkaktuara nga pandemia, ne kemi përsheptuar disa aspekte të progresit tonë drejt përmbylljes së plotë të dixhitalizimit të çdo aspekti të biznesit tonë.

**NE kemi filluar një kapitull të ri, të sigurt dhe me vetëbesim në dekadën tonë të tretë.** SIGAL UNIQA kishte mundësinë që ta kthente vitin 2020 në një kapitull të dalluar në historinë tonë krenare 22 vjeçare. Viti 2020 tregoi se, SIGAL UNIQA është mëse e aftë dhe e mirëpajisur për t'u përshtatur dhe për të lëvizur në harmoni me sfidat aktuale dhe ato të ardhshme si një industri sigurimi që ka hyrë në një epokë të re tërësisht dixhitale.

Mësimet që ne kemi marrë, do të mbeten me ne dhe do të na bëjnë edhe më të fortë.

**SIGAL UNIQA nuk ndalet kurrë!  
Ne formësojmë të ardhmen tuaj!**

*Të dashur zonja dhe zotërinj,  
Të dashur aksionerë,*

Në vitin financiar 2020 për shkak të COVID-19, ne kishim llogaritur me kujdes skenarë të shumëfishtë përpara vendimit të marrë prillin e shkuar për të komunikuar një paralajmërim lidhur me fitimet, si edhe me mungesën e një dividendi. Megjithëse kishim përfshirë me saktësi të gjitha efektet e rënda potenciale, ne e kishim nënvleftësuar fuqinë e biznesit tonë kryesor.

#### Fitimet tejkalojnë pritshmëritë dhe mundësojnë një dividend

Për pasojë, viti financiar i shkuar jo vetëm që ishte ekonomikisht shumë më i mirë sesa pritej në atë kohë, por ne ishim madje të aftë që të amortizonim pagesat e njëhershme të veçanta në këtë vit të jashtëzakonshëm transformimi:

- 99 milionë në dispozita ristrukturimi si një bazë për reduktimin e bazës sonë të kostove të ardhshme;
- 39 milionë në kosto integrimi të njëhershme nga blerja e AXA-s;
- 106 milionë për kostot e lidhura me asetet e paprekshme në Evropën Qëndore dhe Lindore.

**“...viti financiar i shkuar ishte shumë më i mirë nga një këndvështrim ekonomik sesa pritej falë fuqisë së bizneseve tona thelbësore...”**



Andreas Brandstetter  
CEO, Uniqa Insurance Group

**Fitimet përpara tatimit prej 57 milionë euro** të raportuara pas zbritjes së këtyre tre pagesave të njëhershme që arrinin një total prej 244 milionë euro, do të thotë se për vitin financiar 2020 ne mund të propozojmë një dividend në Takimin e Përgjithshëm Vjetor më 31 maj 2021, përkundër parashikimeve tona fillestare në prill të vitit 2020: ashtu si në vitin financiar të mëparshëm, kjo do të arrijë sërish në një shumë prej 18 cent për aksion.

#### 3.6 për qind rritje të primeve

COVID-19 ishte një frenim i rëndësishëm mbi bizneset tona të reja, veçanërisht ndërmjet muajve prill dhe qershor 2020, duke qenë se shumë evropianë ishin të shqetësuar për çështje të tjera sesa me blerjen e sigurimeve. Shpesh për menaxherët tanë në shërbim të konsumatorëve nuk ishte e mundur takimi fizik me klientët tanë ekzistues apo ata potencial. Degët tek partneri ynë strategjik më i rëndësishëm - Grupi

Bankar Raiffeisen - ishin gjithashtu pjesërisht të mbyllura, duke raportuar një reduktim të konsiderueshëm në trafikun e konsumatorëve.

Rrjedhimisht, **rritja e raportuar e primeve prej 3.6 për qind** ishte në mënyrë të konsiderueshme sipër pritshmërive tona. Minus të ardhurat e primeve prej 212 milionë euro nga blerja e re e kompanive të AXA-s në Poloni, Republikën Çeke dhe Sllovakia, të cilat u konsoliduan për herë të parë në tremujorin e katërt të vitit 2020, në përgjithësi ne regjistruam vetëm një rënie të lehtë prej 0.4 për qind, pavarësisht reduktimit të jashtëzakonshëm në bizneset e reja të filluara tashmë për tremujorin e dytë. Ne jemi krenarë për arritjet e kolegëve tanë tek shitjet dhe shërbimi i konsumatorëve:

- Në Austri ne kemi regjistruar një rritje të kënaqshme prej 1.0 për qind.
- Në nivel ndërkombëtar, ne u rritëm me 9.2 për qind me përfshirjen e kompanive të sapoblera të AXA-s. Duke përjashtuar AXA-n, ne regjistruam një rënie prej 4.3 për qind, kryesisht për shkak të një volumi prodhimi më të ulët në marrëveshjet e bashkëpunimit me Bankën Ndërkombëtare Raiffeisen. Kjo rënie në Evropën Lindore dhe Qëndrore përbën vetëm 0.7 për qind pas përshtatjeve të realizuara për diferencat në valutë.

Ne kemi ruajtur bazën tonë të konsumatorëve të rreth dhjetë milionë konsumatorëve (duke përjashtuar AXA-n).

Pas përfshirjes së konsumatorëve nga kompanitë e sapoblera, ne tashmë kemi arritur 15 milionë konsumatorë. Gabimet dhe anulimet ishin brenda kufijve normalë pavarësisht COVID-19. Me 75 për qind, vetëdija e brand-it tonë në Austri mbetet në krye, dhe me disa përjashtime lokale në biznesin e mjeteve motorrike, ishim në gjendje që të ruanim çmimet tona gjerësisht të pandryshuara në një mjedis të vështirë.

#### Humbjet e përmirësuara dhe raporti i përfitimeve

Ne paguam 42 milionë euro më shumë për dëme të lidhura me stuhitë në sigurimin e pasurisë dhe të aksidenteve në vitin 2020 sesa një vit më parë, me pagesa për dëme madhore gjithashtu të larta, dhe targetimi i rreth 70 milionë euro për pagesat e lidhura me COVID-19, kryesisht për ndërprerjen e bizneseve. Duke qenë se, tendenca e mirëpritur e rënies së “dëmeve bazike” të automjeteve motorrike ka vazhduar në vitin 2020, raporti i humbjeve ka rënë në një 63.2 për qindsh shumë pozitiv pavarësisht këtyre pagesave (2019: 64.2 për qind).

Raporti i përfitimeve në sigurimin e shëndetit ra me 2.7 pikë për qind në 82.8 për qind, dhe me 1.4 pikë për qind në sigurimin e jetës në 92.6 për qind, pavarësisht shpenzimeve të njëhershme prej 23 milionë euro. Nivelet e larta të vdekshmërisë për shkak të COVID-19, të cilat u bënë të dukshme në Austri drejt

fundit të vitit nuk janë reflektuar (ende) në portofolin tonë.

Kostot tona u rritën me 11.3 për qind, të cilat janë në mënyrë të konsiderueshme më të larta sesa primet e shkruara (+3.6 për qind). Duke përjashtuar shpenzimet e riskstrukturimit dhe kostot e integritit të deklaruar më sipër, në total 137 milionë euro, të cilat nuk kanë të bëjnë me operacionet aktuale, rritja (për shkak të vazhdiminimit të lartë në investime në teknologjinë e informacionit [IT] dhe projektet strategjike) arrin në 2.6 për qind. Rrjedhimisht, menaxhimi strikt i kostove dhe reduktimi i vazhdueshëm i raportit të kostove janë një prioritet i veçantë për ne brenda qëllimit të programit tonë të ri strategjik “UNIQA 3.0 – Farkëtojmë të Ardhmen”.

**“...në çastin e përfshirjes së kompanive të sapoblera nga AXA, ne tashmë kemi arriur në 15 milionë konsumatorë...”**

**Nivele të larta të qëndrueshmërisë në operacione dhe teknologjinë e informacionit (IT)**

Pavarësisht COVID-19 dhe faktorëve të lidhur me të ku shumica e kolegëve tanë kanë punuar nga shtëpia, Operacionet dhe Teknologjia e Informacionit (IT)

në Austri regjistruan nivele të larta të qëndrueshmërisë vitin e shkuar.

Përveç zbatimit të shpejtë të procedurave të punës nga shtëpia për kolegët tanë mbështetës në mars, IT-ja e përforcoi drejtimin dhe sigurinë e saj, duke dalë gjithashtu live me sistemet e reja ‘front-end’, paralelisht me mbështetjen e tyre për ndërtimin e sistemit kyç të Platformës së re të Sigurimeve të UNIQA (UIP). Operacionet ishin të suksesshme në përmbushjen e niveleve të shërbimeve tona: e vetmja prapambetje në shërbim ishte numri shumë i lartë i konsumatorëve për shërbimet e ndërprerjes së biznesit, të cilat u morën në të njëjtën kohë me mbylljet e detyrueshme.

Në Evropën Qëndrore dhe Lindore, fokusi për të dyja Operacionet dhe IT-në ishte mbi përgatitjen për integrimin e kompanive të AXA-s në tregjet tona kryesore në Poloni, Republikën Çeke dhe Sllovaki.

**Rënia e fitimeve të kapitalit dhe raporti i aftësisë paguese**

Të ardhurat neto të investimeve prej 505 milionë euro ishin 14 për qind apo 80 milionë euro nën shifrat e një viti më parë. Dy arsyt kryesore për këtë janë: shitjet e pronave të papërfunduara në vitin 2020 (2019: 45 milionë euro në të ardhura të jashtëzakonshme) dhe humbjet/dëmtimet nga pjesëmarrja, aksionet, fondet e kapitalit dhe obligacionet me të ardhura fikse (34 milionë euro). Fitimet mesatare në investimet tona të reja (rreth 3 miliardë euro) ranë në mënyrë të konsiderueshme nga 2.8 për qind në 2.07 për qind.

**“...programi ynë i ri strategjik ‘UNIQA 3.0 – Farkëtojmë të Ardhmen’ përfaqëson përgjigjen tonë të fuqishme dhe optimiste ndaj megatendencave madhore në industrinë tonë...”**

Nga një vlerë prej 221 për qind në fund të vitit 2019, raporti i kërkesave rregullatore të kapitalit në kuadër të Aftësisë Paguese II, ra dukshëm në një bazë krahasimi vjetor në 17 për qind: rreth 20 pikë për qind e kësaj rënie janë për shkak të rënies së përgjithshme të normave të interesit në vitin 2020, rreth 30 pikë për qind vijnë nga kompanitë e sapoblera të AXA-s.

**Kontabiliteti dhe menaxhimi i kompanisë**

■ IFRS 17 dhe IFRS 9 (IFRS – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar) do të hyjnë në fuqi në më pak se sa dy vite, p.sh., në janar të vitit 2023. Me shpenzime totale prej më shumë se sa 50 milionë euro, ky projekt madhor jo vetëm që është një kosto dhe që kërkon shumë burime, por ai ndryshon gjithashtu në thelb mënyrën se si ne menaxhojmë biznesin tonë për shkak të ndërvartësive të reja, një konsideratë edhe më të madhe e udhëheqësve të vlerave afatgjata dhe një pamje të

performancës së bizneseve të fokusuara tek e ardhmja dhe tek investitorët. Rrjedhimisht, ne e kemi kthyer këtë tematikë në një prioritet të veçantë në kurset e trajnimit për Bordin e Menaxhimit dhe të Mbikëqyrjes.

- Siç është raportuar, Paneli Austriak për Zbatimin e Raportimit Financiar (OePR) kreu një rishikim zbatues në vitin 2020 të raportimit tonë financiar vjetor 2019 dhe të raporteve financiare gjashtëmujore për vitet 2019 dhe 2020. Ndonëse nuk pati asnjë gjetje në shumicën e fushave të auditit, analiza e testeve të kostove financiare për asetet e paprekshme në Rumani dhe në Bullgari treguan se, supozimet e rritjes dhe çmimet e zbritura të përdorura nga ne nuk ishin në përputhje me kërkesat e IFRP-së në disa raste. Kjo rezultoi në kosto pasuese të aseteve të paprekshme në Rumani dhe në Bullgari në vlerën 55 milionë euro. Përshtatjet korresponduese u kryen me qëllim për të korigjuar gabimet në rezultatet vjetore 2019 në përputhje me IAS 8 (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit) dhe nuk ka asnjë impakt mbi rezultatet e vitit 2020. Ne njoftuam tregun e kapitalit mbi këtë nëpërmjet një njoftimi ‘ad hoc’.

**UNIQA 3.0 – Farkëtojmë të Ardhmen**

Programi ynë i ri strategjik, i cili u prezantua në nëntor dhe që shtrihet nga viti 2021 deri në vitin 2025, përfaqëson përgjigjen tonë të fuqishme dhe optimiste ndaj katër megatendencave madhore në industrinë tonë: normat e ulëta të interesit dhe

zhvendosja e fuqisë ekonomike, ndryshimet demografike dhe sociale, inovacioni dhe dixhitalizimi, si edhe ndryshimet klimaterike dhe qëndrueshmëria.

## “...UNIQA 3.0 është një opion tërheqës për investitorët tanë...”

Rrjedhimisht, ne e kemi menaxhuar biznesin klasik të sigurimeve mbështetur në një strukturë grupi veçanërisht fleksible në të gjitha tregjet tona sipas tre grupeve të konsumatorëve: Shitja me Pakicë, Korporatat dhe Bankat që nga janari 2020. Parimi mbizotërues është një fokus radikal tek konsumatori, në të njëjtën kohë me një reduktim të konsiderueshëm në raportin e kostove.

Ne po udhëheqim inovacionin me modelet më të zhvilluara të biznesit që janë në mënyrë të vetëdijshme jashtë biznesit klasik të sigurimeve nëpërmjet shërbimit tonë dixhital me kosto të ulët CHERRISK dhe në start-up-in tonë të korporatës për shëndetin Sanus X.

Të dashur Aksionerë, “UNIQA 3.0 – Farkëtojmë të Ardhmen” është një program strategjik tërheqës për investitorët tanë. Rritja vjetore mesatare e primeve prej 3 për qind, një reduktim i konsiderueshëm në raportin e shpenzimeve në afërsisht 25 për qind dhe një reduktim në raportin

e kombinuar në një 93 për qind neto, na mundësojnë një fitim mbi kapitalin ndërmjet 8 dhe 10 për qind. Ne kërkojmë që ta kthejmë dividendin për aksion në nivelet e para koronavirusit dhe rritjen e tij sërish çdo vit – në një raport pagese ndërmjet 50 dhe 60 për qind në çdo rast. Raporti rregullator i aftësisë paguese duhet të jetë sipër 17 për qind çdo vit, dhe ne planifikojmë reduktimin e raportit të aftësisë blerëse nga niveli aktual prej rreth 42 për qind në poshtë 35 për qind.

Viti i vështirë i transformimit 2020 tregoi se sa të forta janë bizneset tona kryesore në Evropë. Ne pondëtojmë më tej mbi këtë me UNIQA-n tonë 3.0 dhe duke ecur përpara me vendosmëri zhvillimet e mëtejshme në Grupin e Korporatës sonë. Në emër të të gjithë punonjësve të UNIQA-s, dëshiroj t’ju falënderoj për interesin tuaj në punën tonë dhe për besimin tuaj, dhe unë kam shumë veëtbesim që ne do ta justifikojmë këtë vit me vitin e parë të programit tonë të ri strategjik “UNIQA 3.0 – Farkëtojmë të Ardhmen”.

Vjenë, prill 2021

**Andreas Brandstetter**  
CEO

Uniqa Insurance Group



Drejtoria e Përgjithshme  
Kulla UNIQA, Vjenë

## Të dashur partnerë dhe Klientë,

Me fillimin e dekadës së tretë të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, viti 2020 ishte njëherësh një vit me sfida të paprecedenta si kurrë më parë, por gjithashtu edhe një vit me arritje, realizime dhe fitore të reja dhe të suksesshme, i karakterizuar nga financa të qëndrueshme, vigjilenca, mprehtësia dhe zhdërvjelltësia e burimeve tona njerëzore dhe oferta jonë dixhitale e pakohë. Megjithatë, ky vit ishte gjithashtu i pasur në sfida – kriza shëndetësore më e rëndë e shekullit të fundit me pandeminë COVID-19, vijimi i pasojave shkatërruese të dy tërmeteve që goditën Shqipërinë në 2019 dhe vazhdimi i pagesës së dëmeve – SIGAL UNIQA provoi edhe një herë se vizioni dhe strategjia jonë e biznesit mundësoi edhe një herë përshtatjen me shpejtësi dhe me më shumë lehtësi ndaj mënyrave të reja të shërbimit ndaj klientëve dhe mbrojtjes së punonjësve tanë.

Një vit pas fillimit të pandemisë SIGAL UNIQA qëndron solide, njëherësh financiarisht

**Gjatë këtij viti, ne e rritëm biznesin tonë duke zgjeruar bazën e klientëve, të partnerëve dhe të stafit tonë, dhe lançuan produkte dhe shërbime të reja online.**



Avni PONARI  
CEO, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

dhe përsa i takon kënaqësisë së klientëve, partnerëve dhe të punonjësve tanë për punën dhe shërbimin tonë. Gjatë këtij viti, ne e rritëm biznesin tonë duke zgjeruar bazën e klientëve, të partnerëve dhe të stafit tonë, dhe lançuan produkte dhe shërbime të reja online. Më konkretisht, SIGAL UNIQA solli për herë të parë dhe e vetmja në tregun shqiptar në të tria vendet ku ajo operon – në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut – 1) Paketën e Sigurimit Anti-Covid; 2) Paketën e sigurimit të Nxënësve dhe Studentëve, duke përfshirë Covid-19 dhe sigurimin e jetës së prindërve; 3) Shërbimin e Telemjekësisë, etj. Ne mbetemi të disiplinuar në menaxhimin e portofoleve tona, të cilat janë të mirëdiversifikuara dhe me investime të një cilësie shumë të lartë. Për më tepër, ne po punojmë për rritjen e besimit në një shoqëri dixhitale nëpërmjet angazhimit tonë ndaj të dhënave që udhëheqin industrinë ku ne operojmë.

Si SIGAL UNIQA, po punon me grupe të rinjsh për të përftuar një këndvështrim më të 'freskët' dhe më rinor mbi atë se ku jemi dhe se ku po shkojmë. Gjithashtu, ne kemi punuar fort për të tërhequr gjeneratën më të talentuar drejt nesh nëpërmjet një sërë mënyrash. Për të ofruar shërbimet, produktet dhe zgjidhjet më të mira për klientët tanë, ne kemi nevojë që të kemi në dispozicionin tonë dhe të klientëve tanë, talentet më të mira. Ne jemi krenarë për punonjësit tanë besnikë dhe të përkushtuar dhe për këtë qëllim ne vazhdojmë që të promovojmë një kulturë pune të mbështetur tek merita.

**SIGAL UNIQA është e vendosur dhe e angazhuar që të farkëtojë dhe formësojë një të ardhme, ku ne mund të lulëzojmë të gjithë së bashku.**

Në këtë epokë të paprecedentë ndryshimesh, SIGAL UNIQA është e vendosur dhe e angazhuar që të farkëtojë dhe formësojë një të ardhme, ku ne mund të lulëzojmë të gjithë së bashku. Për thujse 22 vjet, SIGAL UNIQA ka mbrojtur ata që na kanë besuar. Ne po ndërtojmë më tej mbi këtë trashëgimi për t'i shërbyer nevojave, kërkesave dhe pritshmërive të klientëve,

punonjësve, partnerëve dhe shoqërisë sonë, dhe për të punuar së bashku me ta për t'u siguruar që ata të jenë sa më të mirëpajisur për përballimin e këtyre ndryshimeve që po ndodhin në komunitetet tona; qoftë të udhëhequra nga ndryshimet klimaterike apo efektet e teknologjisë, apo faktorë të tjerë jashtë kontrollit tonë. Për këtë qëllim, ne kemi rifreskuar qëllimet tona, për të krijuar një të ardhme më të ndritur së bashku, duke ripërcaktuar vazhdimisht se kush jemi, kush janë përfituesit tanë, dhe cili është impakti që ne dëshirojmë që të kemi në jetën e klientëve tanë në këtë epokë dixhitale.

Ne filluam transformimin e biznesit tonë në një model të dominuar nga dixhitalizimi i shërbimeve dhe produkteve tona vite më parë. Kur filloi pandemia, ne ishim gati për të ofruar shërbime plotësisht dixhitale për klientët dhe punonjësit tanë. Gjatë mbylljes dhe periudhave më kritike të mbylljeve të detyrueshme dhe kufizimit të lëvizjeve për shkak të COVID-19, kolegët tanë filluan të punonin në distancë dhe vazhduan t'i shërbenin klientëve tanë 24/7, po ashtu. Shërbimi ynë i klientëve 24/7 vazhdoi që t'i mbështeste klientët tanë pandërprerje nëpërmjet shërbimeve dixhitale online. Këto arritje të shkëlqyera janë një testament për angazhimin tonë për të dëgjuar dhe vepruar mbi nevojat e njerëzve. Duke parë përpara, ne planifikojmë ruajtjen e këtij momentumi, duke zgjeruar më tej ofertën tonë dixhitale.

Përgjatë vitit 2020, SIGAL UNIQA i ka kushtuar një theks shumë të fortë kujdesit dhe mbrojtjes maksimale për punonjësit tanë të

vijës së parë bënë përpjekjet maksimale për t'u siguruar që konsumatorët tanë të ndjenin vazhdimisht praninë tonë mbështetëse gjatë këtij viti. Teksa dixhitalizimi po e bën gjithnjë edhe më të lehtë për të blerë online, ne po vazhdojmë që të targetojmë rritjen e kënaqësinë nga klientët tanë dhe ndërtimin e ruajtjen e besnikërisë së tyre. Ne kemi dëgjuar veçanërisht nga afër rritjen e kërkesës nga klientët tanë tregtar për shërbimet e mbulimit dhe të parandalimit të rrezikut. Dhe, ne po punojmë më tej për ofertën tonë ekzistuese për të ofruar këndvështrime, analiza, shërbime dhe instrumente për t'i ndihmuar ata që të kuptojnë më mirë, që të menaxhojnë, të pranadalojnë dhe të zvogëlojnë rreziqet me të cilat ata përballen në jetët dhe në punët e tyre.

Viti 2020 përforcoi kredencialet tona si një punëdhënës i përgjegjshëm për rreth 1,700 kolegët dhe partnerët tanë ekskluzivë të shitjeve në vend dhe në rajon. Falë angazhimit tonë afatgjatë për të rritur aftësitë dhe ritrajnuar forcat tona të punës, si edhe promovimin e një komunikimi më të ngushtë me punonjësit tanë, ne ishim në gjendje që t'i përgjigjeshin nevojave të kolegëve tanë me zhdërvjelltësi dhe vetbesim. Përveç ofrimit të mbështetjes dixhitale për mirëqenien dhe shëndetin mendor, ne i ofruam punonjësve tanë testimin falas dhe analizat për koronavirusin e ri.

2020 ishte një vit sfidues për të gjithë botën. E megjithatë, ai ishte gjithashtu një vit që i dha të drejtë qasjes tonë afatgjatë të biznesit. Themelet tona solide dhe të qëndrueshme të viteve të fundit e kanë bërë SIGAL UNIQA më shumë fleksible. Kjo

do të thotë se, ne kemi qenë në gjendje që të reagojmë me shpejtësi ndaj mjedisit në ndryshim, duke përforcuar lidhjet tona me klientët, punonjësit dhe komunitetet në të cilat ne jetojmë dhe punojmë. Është besimi dhe besnikëria afatgjatë e aksionerëve tanë që na kanë lejuar që të zbatojmë vizionin tonë afatgjatë dhe për të përfituar nga aftësia rikuperuese që ato sjellin.

## Themelet tona solide dhe të qëndrueshme të viteve të fundit e kanë bërë SIGAL UNIQA më shumë fleksible.

Për ta përmbyllur dhe duke ju falënderuar përzemësisht të gjithëve për besimin që keni tek ne dhe për mbështetjen tuaj në këtë rrugëtim, unë jam i mbushur me krenari për arritjet tona dhe ndjehem jashtëzakonisht optimist për vitet përpara nesh.

Miqësisht,

**Avni PONARI**  
CEO  
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a

# Ne jemi SIGAL UNIQA

NE jemi kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri, ku udhëheqim tregun vendas që prej vitit 2002, duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut.

Grupi SIGAL UNIQA është një familje e madhe që numëron mbi 1500 punonjës dhe agjentë, të cilët u shërbejnë 1 milion klientëve në tre shtete: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e veriut.

SIGAL UNIQA është ndër grupet më të mëdhenj financiarë në rajon, i përbërë nga 7 kompani sigurimesh dhe 1 fond pensioni privat dhe zotëron 121.2 milionë Euro asete, numëron mbi 72 milionë Euro prime të shkruara për vitin 2020 dhe rreth 300 milionë Euro dëme të paguara ndër vite.

### Volumi i Primeve (Euro)

Group	68,533,000
AL	38,836,000
KS	13,277,000
MK	16,420,000

### Nr. i Zyrave


Group	1136
AL	630
KS	131
MK	375

### Nr. i Kontratave

Group	922,909
AL	333,147
KS	83,348
MK	506,414

### Punonjës dhe Agjentë

Group	1936
AL	1181
KS	206
MK	549



**EQL: një rajon me pootencial të lart**  
 Mesataria e shpenzimet për sigurime për frymë në Euro për vitin 2020

Gjermani	2,614
Bashkimi European	2,249
Austria	2,002
Republika Çeke	542
Slovakia	478
Polonia	391
Hungaria	368
Kroacia	350
Bullgaria	214
Mali i Zi	152
Rusia	139
Serbia	131
Rumania	119
Bosnje dhe Herzegovina	116
Maqedonia e Veriut	83
Kosova	56
Shqipëria	50
Ukraina	44

- Europa Qendrore (EQ)
- Europa Lindore (EL)
- Europa Juglindore (EIL)
- Rusia

Numri tregon pozicionin në tregun e sigurimeve në vendin përkatës.

<sup>1)</sup> Për tregun e sigurimeve të jetës në Rusi


# UNIQA - NJË PREJ KOMPANIVE MË TË MËDHA TË SIGURIMEVE NË EUROPË

Grupi UNIQA është një nga kompanitë lidere të sigurimit në tregjet e tij kyçe në Austri dhe Evropën Qëndrore dhe Lindore. Rreth 23,500 punonjës dhe partnerë ekskluzivë shitjesh i shërbejnë rreth 15.5 milionë klientëve nëpër 18 vende. UNIQA është grupi i dytë më i madh i sigurimeve në Austri me mbi 21 për qind të tregut. Në tregun në rritje në Evropën Qëndrore dhe Lindore, UNIQA është e pranishme në 15 tregje: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Hungari, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Poloni, Rumania, Rusi, Serbi, Sllovakia dhe Ukrainë. Për më tepër, kompanitë e sigurimit në Zvicër dhe Lihtejshtajn janë gjithashtu pjesë e Grupit UNIQA.

% sipas produkteve



... në tregun në Austri dhe Evropën Qendrore dhe Lindore



Shpërndarja e primeve



# PARIMET DHE VLERAT TONA

Jetojmë më mirë, së bashku

Që nga viti 1999, njerëzit na kanë besuar dhe janë siguruar me ne, dhe misioni ynë nuk ka ndryshuar: rreziqet që nuk mund të mbahen vetëm nga individët, mbahen nga të gjitha “shpatullat” e komunitetit tonë. Baza e suksesit dhe potenciali i ynë i ardhshëm është ofrimi i shërbimeve dhe produkteve të klasit të parë për mbi 1 milionë klientë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut dhe ne po ndjekim një kurs rritjeje, duke fuqizuar konsiderueshëm pozicionin tonë në tregun vendas dhe atë rajonal.

## Klientët të parët

Ne jemi të organizuar rreth segmenteve të klientëve tanë tek shitjet me pakicë, sipërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha dhe tek bankat. Ne jemi vendosmërisht të fokusuar tek nevojat dhe kërkesat e tyre, duke kërkuar vazhdimisht mendimet e tyre.

## Të përgjegjshëm

Ne marrim përgjegjësitë tona dhe kërkojmë zgjidhjet më të mira dhe më të shpejta për klientët tanë. Ne fokusohemi tek klientët dhe aksioni dhe jo tek burokracia.

## Komuniteti

Ne mbështesim gjithashtu njëri-tjetrin përtej përgjegjësisë tona të përcaktuara për t'i shërbyer klientëve tanë me sa më shumë efektivitet që të jetë e mundur. Ne jemi të angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit tonë.

## Thjeshtësia

Ne priorizojmë ofrimin e zgjidhjeve të thjeshta, të menjëhershme dhe të sakta. Për ne bashkëbisedimi dhe diskutimet personale janë kyçe dhe të parat në komunikimet tona me klientët, duke reduktuar komunikimet e shkruara burokratike, por zgjidhjet me veprime konkrete.

## Integriteti

Ne jemi të vendosur ndaj vlerave dhe politikave tona në të gjitha veprimet tona. Komunikimi transparent është pjesë e jetës sonë të përditshme. Ne bëjmë gjithçka që mundemi për të mbajtur premtimet tona.

# ÇFARË KËRKOJMË TË JEMI?

Më shumë se sa thjesht një kompani sigurimi

## Të lëvizim drejt një të ardhmeje të suksesshme

Shoqëria jonë po përballlet me sfida madhore: pandemia COVID-19 veç të qenit një krizë shëndetësore e paprecedentë, po shkakton gjithashtu një krizë të rëndë në ekonominë reale. Njerëzit në Shqipëri në veçanti, dhe në Evropë në përgjithësi, po plaken dhe po lindin gjithnjë edhe më pak fëmijë. Dixhitalizimi po ofron shumë mundësi për inovacion. Ndryshimet klimaterike dhe katastrofat natyrore përbëjnë një sfidë madhore për bujqësinë dhe impaktin e tyre tek shëndeti i njerëzve. Përkundrejt këtij peisazhi, SIGAL UNIQA si pjesë e Grupit Ndërkombëtar të Sigurimeve UNIQA ka formuluar dhe është pjesë e një strategjie afatgjatë.

## Ngritja e themeleve të qëndrueshme

Nga dyfishimi i bazës së klientëve tanë deri në rritjen e konsiderueshme të fuqisë tonë fituese në biznesin e sigurimeve, ne kemi investuar vazhdimisht në një program të gjerë investimesh në Teknologjinë e Informacionit në historinë tonë.

## Farkëtojmë të ardhmen

Ne dëshirojmë dhe kërkojmë që të shikojmë një rritje të qëndrueshme të rëndësisë sonë në jetën e klientëve tanë. Nëse ne duam që ta përmbushim këtë objektiv, ne duhet të

evoluojmë më tej sërish, duke shërbyer si aleat, motivues dhe frymëzues për klientët tanë.

## Megatendencat që po ndryshojnë përgjithmonë segmentet e biznesit tonë

Për ne është shumë e rëndësishme të vlerësojmë me kujdes se si do të jetë e ardhmja për njerëzit në përgjithësi. Për këtë ne kemi analizuar nga afër megatendencat vendase, rajonale dhe globale kyçe, si edhe impaktin e tyre mbi biznesin tonë.

## Ndryshimet demografike dhe sociale

Njerëzit po plaken dhe po bëjnë gjithë edhe më pak fëmijë dhe kjo do të thotë se nevojat për fonde private po rritet. Popullsia, migracioni neto dhe lindshmëria po bien, ndërsa mosha mesatare dhe tendeca drejt urbanizimit po rriten.

## Përgjigjja jonë ndaj së ardhmes

Programi i rritjes “UNIQA 3.0 – Farkëtojmë të ardhmen” (si pjesë e Grupit Ndërkombëtar të Sigurimeve UNIQA) përfaqëson një përgjigje pozitive ndaj sfidave të shkaktuara nga këto megatendencat. Vizioni ynë thelbësor është përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së klientëve tanë, dhe jo vetëm thjesht zvogëlimi i pasojave të shëndetit, dëmtimeve dhe humbjeve.

## ÇFARË ËSHTË E RËNDËSISHME PËR NE:

Transparenca, dialogu dhe paanësia

Katër shtylla strategjike përcaktojnë kursin tonë të përgjithshëm:

- 1 Njerëzit & kultura**  
NE po transformojmë kulturën e Grupit tonë, duke i ofruar punonjësve dhe klientëve tanë një përvojë të jashtëzakonshme.
- 2 Brand-i & komunikimi**  
NE mbetemi brand-i lider në vend në Shqipëri, dhe me gjerë në rajon në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut, si ofrues shërbimesh dhe produkte, si edhe si punëdhënës.
- 3 Qëndrueshmëria**  
NE jemi të kujdesshëm ndaj çështjeve mjedisore dhe sociale në aktivitetet e Grupit tonë.
- 4 Diversiteti**  
NE promovojmë diversitetin mbështetur në bindjen tonë që sa më shumë të ndryshëm që të jemi aq më i lartë është potenciali për inovacion dhe rritje.

## KUSH ËSHTË UNIQA?

NJË PREJ KOMPANIVE MË TË MËDHA TË SIGURIMEVE NË EVROPË

### Rreth Grupit

Grupi UNIQA është një nga kompanitë lidere të sigurimeve në tregjet kyçe të Austrisë dhe Evropës Qëndore dhe Lindore (EQL). Rreth 23,500 punonjës dhe partnerë ekskluzivë shitjesh i shërbejnë rreth 15.5 milionë klientëve nëpër 18 vende. UNIQA është grupi i sigurimeve i dytë më i madh në Austri, ku zë 21 për qind të tregut. Në rajonin në rritje të EQL, UNIQA prezantohet në 15 tregje: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Hungari, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki dhe Ukrainë. Për më tepër, kompanitë e sigurimeve në Zvicër dhe Lihtejshtajn janë gjithashtu pjesë e Grupit UNIQA.

### Austria: brand i fuqishëm, pozicion i fortë

UNIQA e ka operuar biznesin e saj të sigurimeve në tregun e saj vendas në Austri për më shumë sesa 200 vjet. Duke udhëhequr tregun me 21 për qind, UNIQA është tani kompania e dytë më e madhe e sigurimeve në Austri, dhe renditet e para në segmentin e shëndetit. UNIQA i shërben 3.7 milionë klientëve në Austri, ose drejtëpërdrejtë apo nëpërmjet partnerit të tyre bankar dhe të shitjeve Raiffeisen. Faktorët kyç në pozicionin e UNIQA në treg janë produktet novatore, një forcë e fuqishme

shitjesh dhe brand-et e mirëvendosura të UNIQA-s dhe Raiffeisen-it. Rritja e konsiderueshme ekonomike e pritur në vijim të përfundimit të krizës së COVID-19, një mjedis i qëndrueshëm politik dhe një rregullator i kujdesshëm do të hapin gjithashtu prospektet e mira për të ardhmen. Kjo është për shkak se ka ende një potencial në tregun e sigurimeve austriake: Aktualisht, austriakët shpenzojnë mesatarisht 2,002 euro në sigurime çdo vit. Kjo mbetet ende relativisht e ulët krahasuar me vende e tjera të Evropës perëndimore, veçanërisht për shkak të standardit të lartë të jetesës në Austri.

### Evropa Qëndore dhe Lindore: Potencial i jashtëzakonshëm në densitetin e sigurimeve

Shpenzimet e sigurimeve në EQL aktualisht janë ende poshtë këtij niveli. Me një prim mesatar vjetor prej 233 euro për frymë, EQL kontribuon një total prej 40 për qind të primeve të Grupit UNIQA në vijim të blerjes së kompanive të AXA-s në Poloni, Republikën Çeke dhe Sllovaki. Megjithatë, edhe pjesa tjetër e rajonit po përparon në këtë drejtim: primet mesatare për frymë janë tashmë në 425 euro në tregjet më të zhvilluara të Evropës Qëndrore në Republikën Çeke, Hungari, Poloni, dhe Sllovaki, që UNIQA i ka përcaktuar si tregun e dytë bazë, dhe kjo tendencë është në rritje.

## Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA Group Austria



Andreas Brandstetter  
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA  
CEO i UNIQA Insurance Group



Erhard Busek  
Zv. Kryetar i Bordit  
Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



Wolfgang Kindl  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA  
CEO i UNIQA International



Alexander Breit  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA



Gerald Mueller  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA

### Grupi SIGAL UNIQA

SHQIPERI	KOSOVE	MAQEDONI
SIGAL UNIQA Jo Jetë dhe Risigurime	SIGAL UNIQA Jo Jetë	UNIQA Jo Jetë
SIGAL Life UNIQA	SIGAL Life UNIQA	UNIQA Life
Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA		

### Aksionerët tanë

13.1%

Investitorë Vendas



86.9%

UNIQA Insurance Group

# NGJARJET KRYESORE 2020

TË SUKSESSHËM DREJT DEKADËS 3 TË SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

**Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari u nderua më 20 janar 2020 me Dekoraten: "Urdhëri i Diellit që Ngrihet, Rrezet e Arta dhe Fjongo e Qafës" nga Perandori i Japonisë**

Qeveria Japoneze i akordoi Z. Avni PONARI Dekoraten "Urdhri i Ngritjes së Diellit, Rrezet e Arta me Fjongon e Qafës" ("The Order of the Rising Sun, Gold Rays with Neck Ribbon"), Urdhëri i 3-të më i lartë që akordohet nga Qeveria Japoneze, themeluar në vitin 1875 që i akordohet personaliteteve të huaja për arritje të jashtëzakonshme në marrëdhëniet ndërkombëtare, promovimin e kulturës japoneze, dhe avancimin e fushave të ndryshme të akorduara Z. Ponari si Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë në Shqipëri për kontributin e tij të jashtëzakonshëm për promovimin e shkëmbimeve dhe të fuqizimit të mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore ndërmjet Shqipërisë dhe Japonisë. Ai simbolizon energjinë po aq të fuqishme sa ngritja e diellit paralelisht me konceptin japonez të "ngritjes së diellit" – që e kanë bërë Japoninë që të njihet si "Toka e Ngritjes së Diellit".

"Kam bërë maksimumin tim që të



Gjatë dekorimit të Z. Ponari nga Ambasadori i Japonisë SHTZ. Ito Makotot, 20 janar 2020

prezantoja denjësisht Shqipërinë në "Tokën ku Ngrihet Dielli", dhe që të përfaqësoja Japoninë në "Tokën e Arbrit"; "Ne kemi shumë për të mësuar nga dija e madhe dhe mënyrat e të bërit të gjërave në të gjitha rrafshet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe me punën time si Konsull jam përpjekur që të sjell në Shqipëri praktikën më të mira të zhvillimit dhe të të bërit biznes," u shpreh Z. Ponari në fjalën e tij përshëndetëse dhe falenderuese, duke e përmbyllur me mesazhin që tashmë, "Japonia është një mike e madhe, shumë e rëndësishme dhe e

çmuar për Shqipërinë, që na përkrah dhe mbështet kurdoherë".

"Kjo Dekorata e lartë vlerëson devotshmërinë dhe kontributin e jashtëzakonshëm që Z. Avni Ponari ka treguar dhe dhënë në dhjetë vitet e shërbimit të tij si Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë në Shqipëri, në mbrojtjen e mirëqenies së kompanive, turistëve, të qytetarëve të thjeshtë japonezë që jetojnë në Shqipëri, të promovimit të shkëmbimeve kulturore, ndërtimin e mirëkuptimit reciprok, si edhe për njohjen dhe afrimin e popujve të Japonisë dhe Shqipërisë," u shprehën Z. Ito Makoto, Ambasador i Japonisë në Shqipëri dhe Z. Besnik Mustafaraj, Ish Ministër i Jashtëm i Shqipërisë gjatë ceremonisë së dekorimit të Z. Ponari.

**SIGAL UNIQA shpallet fituese e Çmimit të Filantropisë 2019 në Nivel Kombëtar**

Më 7 shkurt 2020, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim vlerësuan filantropinë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA duke i akorduar Çmimin e Filantropisë 2019 në Nivel Kombëtar me motivacionin: "Për angazhim dhe kontribut të gjerë në shëndetësi, arsim, mjedis, art, sport dhe edukim financiar në fushën e sigurimeve, ku veçohen: Klinika Lëvizëse Mjekësore në shkallë vendi, rikonstruksioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar "Matosh UKA" në Fierzë, Tropojë dhe Pallatit të Sportit në Përmet, si dhe krijimi i Klubit "Art dhe Kulturë" në dispozicion për të gjithë qytetarët e Durrësit".



Gjatë ceremonisë së Çmimeve të Filantropisë, Z. Avni Ponari dhe Ministria e Ekonomisë Anila Denaj

**Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari merr pjesë në Dëgjuesën Publike "Zbatimi praktik i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara"**

Z. Avni PONARI, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut ishte pjesëmarrës në DËGJESËN PUBLIKE "ZBATIMI PRAKTIK I OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA", që u mbajt në Pallatin e Kombeve në Gjenevë, e organizuar nga Asambleja Evropiane e Biznesit, në Mbretërinë e Bashkuar.

**SIGAL UNIQA organizoi Workshop Rajonal për Trajtimin e Dëmeve Motorrike**

Z. Avni PONARI, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e

Veriut ishte pjesëmarrës në Workshop Rajonal për “Trajtimin e Dëmeve Motorrike” të Kompanive të Grupit SIGAL UNIQA Group AUSTRIA në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut”, e organizuar më 24 shkurt 2020, në Strugë.

### Fondi i Pensioneve “SIGAL” me Administrator dhe zyra të reja

Z. Elvis Ponari, emërohet Administrator i Përgjithshëm i Fondit të Pensioneve “SIGAL”. Njëherësh, Fondi u transferua më 27 maj 2020 në një godinë të re me adresë: Rr. “Donika Kastrioti”, pas Kullave Binjake, ndërmjet Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë. Pranë këtyre zyrave klientët e SIGAL UNIQA mund të kryejnë gjithashtu shërbimet për të gjitha produktet e sigurimit dhe trajtimit të dëmeve motorrike.



Drejtoria e Fondit të Pensioneve SIGAL

### Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari nderohet nga Revista Prestigjose e Biznesit ‘BUSINESS SIGHT MAGAZINE’ si CEO Revolucionar për vitin 2020

Z. Avni PONARI, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA u nderua më 8 qershor 2020 nga REVISTA PRESTIGJOZE e Biznesit ‘BUSINESS SIGHT MAGAZINE’: CEO Revolucionar për vitin 2020 për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në botën e biznesit. Rrjetja e jashtëzakonshme, praktikat e biznesit, përkushtimi profesional dhe udhëtimi i suksesshëm i Z. Ponari ishin ndër të tjera çka tërhoqën vëmendjen e Prestigjoses ‘Business Sight Magazine’.

### Organizimi i Degëve të SIGAL në Tiranë me 5 zyra

Rrjetit të 900 zyrave të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA iu shtua më 13 qershor një Zyrë e RE – Dega Nr. 3, në Tiranë. Hapja e kësaj Dege të Re Nr. 3 vjen në përputhje me objektivat e strategjisë së zgjerimit të Kompanive të Grupit SIGAL UNIQA me adresë: Kompleksi Delijorgji Bulevardi “Gjergj Fishta”, pranë Urës së Re, Tiranë. Pranë këtyre zyrave klientët e SIGAL UNIQA mund të kryejnë të gjitha shërbimet për të gjitha produktet e sigurimit dhe anëtarësimin në Fondin e Pensioneve Private të SIGAL UNIQA.

### Hapja e Zyrave të Reja të SIGAL UNIQA në Durrës

Rrjetit të më shumë se 900 zyrave të kompanisë SIGAL UNIQA iu shtua më 3



korrik zyrat e reja, Dega Nr. 2, në qytetin e Durrësit, përkatësisht: Në Bulevardin kryesor, Rruga Tregtare, pranë Bashkisë Durrës. Pranë zyrave të reja, klientët e SIGAL UNIQA do të marrin të gjitha shërbimet, që nga blerja e të gjitha llojeve të siguracioneve e deri tek marrja e dëmshpërblimit, në rast aksidenti apo dëmtim prone, biznesi etj. Më herët SIGAL UNIQA e zgjeroi sërish rrjetin e zyrave të saj në shërbim të klientëve në 2 pika strategjike të Tiranës, prapa Kullave Binjake në pallatin e ri Teknoprojekt - Dega Nr.2, dhe në Bulevardin Gjergj Fishta, në kompleksin Delijorgji - Dega Nr. 3.

### SIGAL UNIQA nënshkruan marrëveshje për publikimin e të dhënave online me Bursën Shqiptare të Titujve

Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondit të Investimeve nënshkruan më 21 korrik 2020 Marrëveshjen për publikimin e të dhënave online me Bursën Shqiptare të Titujve.

### SIGAL UNIQA renditet në TOP 200 kompanitë më të mëdha dhe e para në tregun e sigurimeve shqiptare

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA vijon të renditet në TOP 200 KOMPANITË MË TË MËDHA dhe E PARA NË TREGUN SHQIPTAR TË SIGURIMEVE përgjatë 2019 sipas të dhënave dhe analizave të Revistës MONITOR. Ky vlerësim vjen pas një viti të pasur në sfida – dy tërmete shkatërruese dhe pagesa e dëmeve - i karakterizuar nga një mjedis dinamik zhvillimesh të ndryshueshme, por objektivat tonë financiar ambicioz përgjatë vitit, u tejkaluan dhe mirëbesimi dhe besimi i klientëve tek biznesi ynë mbetet solid dhe vazhdon të rritet çdo ditë. Ne mbetemi të vendosur në përballimin e multisfidave aktuale, të së ardhmes, si edhe të zhvillimeve radikale në sektorin tonë.

### Vizitë Virtuale në SIGAL UNIQA

SIGAL BUSINESS CENTRE - QENDRA E BIZNESIT ME SHËRBIMET PROFESIONALE SIGURUESE MË GJITHËPËRFSHIRËSE! SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA vijon të jetë kompania e parë në tregun shqiptar të sigurimeve, ku SIGAL UNIQA Group AUSTRIA udhëheq tregun vendas që prej vitit 2002, duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut. Në përputhje me objektivat dhe zhvillimin tonë strategjik, NE vazhdojmë të rritemi e të zgjerohemi dita ditës, duke përforcuar më tej pozitën dhe praninë tonë në treg, si një nga grupet financiar të sigurimeve më të fuqishëm në Shqipëri, Kosovë

dhe në Maqedoninë e Veriut. Me një staf profesionistësh multidisiplinar prej 200 punonjësish dhe 80 zyra ofrojmë shërbimet tona për MARRJEN NË SIGURIM dhe NË RAST DËMI për mbi 42 produkte. SIGAL BUSINESS CENTRE përfshin gjithashtu: 3 salla mbledhje dhe trajnimi; Muzeun e parë të Sigurimeve në Rajon; Klubin e Shëndetit për të gjithë të siguarit e SIGAL; Ambjente shërbimi për stafin.

### Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari nderohet nga Dekanati i Universitetit Europian të Tiranës

Dekanati i Universitetit Europian të Tiranës vlerësoi më 8 tetor 2020 Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA me TITULLIN E MIRËNJOHJES "Për rolin dhe kontributin e tij në zhvillimet ekonomike dhe sociale në vend, për angazhimin në përmirësimin e përhershëm të programeve të studimit të brezit të ri dhe asistimin e tyre me programet e intershipit dhe punëve kërkimore për të nxitur inovacionin në biznes, si edhe për edukimin mbi sigurimet dhe përfaqesjen ndaj shëndetit

e sigurisë së jetës gjatë pandemisë COVID-19".

### Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari nderohet nga Revista Prestigjioze e Biznesit 'INSIGHT SUCCESS MEDIA TECH': "20 CEO me performancën më të mirë në vitin 2020"

Z. Avni PONARI, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA u nderua më 2 nëntor nga REVISTA PRESTIGJOZE e Biznesit 'INSIGHT SUCCESS MEDIA TECH': "20 CEO ME PERFORMANCËN MË TË MIRË NË VITIN 2020" për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në botën e biznesit nëpërmjet arritjeve, zhvillimit, pozicionimit të fuqishëm strategjik në treg dhe disiplinën operacionale dhe ekzekutive përgjatë dy dekadave. INSIGHT SUCCESS MEDIA TECH' është një platformë e orientuar ndaj progresit, duke u fokusuar ekskluzivisht tek kompanitë lidere, stilin e tyre reformues të të bërit biznes dhe ofrimin e mënyrave efektive dhe të zgjidhjeve bashkëpunuese për fuqizimin e pozicionit në treg.

### Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL

### UNIQA, Z. Avni Ponari merr pjesë në takimin mbi "Tendencat e zhvillimit të aktivitetit filantropik në vend në përballimin e situatës pandemike"

Z. Avni PONARI, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, ishte pjesëmarrës në takimin mbi "TENDENCAT E ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT FILANTROPIK NË VEND NË PËRBALLIMIN E SITUATËS PANDEMIKE", në kuadër të "JAVËS SË FILANTROPISË" të organizuar më 10 nëntor 2020 nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të biznesit, të trupës akademike, studentëve dhe të shoqërisë civile. Gjatë fjalës së tij, Z. Ponari foli mbi sfidat e shumëfishta të këtij viti, por jo vetëm, duke përfshirë peisazhin e pasigurisë së përgjithshme ekonomike dhe impaktin financiar të COVID-19 përgjatë vitit 2020, në përgjithësi, si dhe dy tërmeteve të vitit 2019, në veçanti, efekti financiar i të cilëve vijon të ndjehet akoma në ekonominë tonë.

### SIGAL UNIQA nënshkruan marrëveshje për publikimin e të dhënave online me Bursën Shqiptare të Titujve

Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë dhe Shoqata Austriake e Sigurimeve nënshkruan më 18 nëntor një Memorandum Mirëkuptimi.

### SIGAL UNIQA vlerësohet maksimalisht nga organizmat më prestigjiozë financiar ndërkombëtar

Përkushtimi dhe profesionalizmi i mbi 1,700 punonjësve që u shërbejnë më shumë se 1 milionë klientëve dhe drejtimi nga lidershipi vizionar i SIGAL UNIQA, u vlerësua maksimalisht nga organizmat më prestigjiozë financiarë ndërkombëtarë, SEENEWS dhe FINANCE CENTRAL EUROPE, duke e vlerësuar SIGAL UNIQA Group Austria si "KOMPANIA NR. 1 E SIGURIMEVE NË SHQIPËRI" dhe si një nga "100 KOMPANITË MË TË MIRA NË EUROPËN JUGLINDORE".

Revista Finance Central Europe, ndër të tjera vlerëson punën e shkëlqyer të themeluesit dhe drejtuesit të SIGAL UNIQA, Z. Avni PONARI, duke e vlerësuar si "DREJTUESI MË I MIRË I SIGURIMEVE NË SHQIPËRI DHE EUROPËN JUGLINDORE".



Superbrand of Albania



Ranked among the Best Performing Insurance Companies in Southeast Europe





### Analiza Vjetore Financiare 2020 e Fondit të Pensioneve Private SIGAL UNIQA

Përmbillet me sukses ANALIZA FINANCIARE 2020 e FONDIT TË PENSIONEVE PRIVATE SIGAL UNIQA. Të pranishëm në takim ishin Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe Z. Elvis Ponari, Administrator i Përgjithshëm i Fondit të Pensioneve Private SIGAL UNIQA. Fondi i Pensioneve Private të SIGAL UNIQA vazhdon rrugëtimin e tij përpara më solid se kurrë!

### Analiza Vjetore Financiare 2020 e SIGAL UNIQA

Përmbillet me sukses ANALIZA FINANCIARE 2020 E GRUPIT SIGAL UNIQA në SHQIPËRI, KOSOVË dhe MAQEDONINË E VERIUT, duke lënë pas një vit tejet sfidues si kurrë më parë. Pavarësisht të gjithave, vijojmë të udhëheqim tregun vendas dhe atë rajonal të sigurimeve.



### Bordi Drejtues i Grupit SIGAL UNIQA

(Nga e majta në të djathtë) Saimir Dhamo (CEO i SIGAL UNIQA Group Austria Kosova), Alma Totokoçi (Zv. Drejtore e Përgjithshme e SIGAL UNIQA Group Austria), Avni Ponari (CEO i Grupit SIGAL UNIQA Group Austria), Edvin Hoxhaj (Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL Life UNIQA Group Austria), Driton Azizi (Drejtor i Përgjithshëm i UNIQA Maqedoni e Veriut) dhe Elvis Ponari (Administrator i Përgjithshëm i Fondit të Pensioneve Vullnetare SIGAL Life UNIQA Group Austria)

## Misioni ynë

Një kompani shqiptare me standarte europiane si SIGAL UNIQA Group Austria e ka të qartë misionin e saj: të paguajë në kohë rekord dëmet dhe të mbrojë qytetarët mbi bazën e kontratave të sigurimit.

Përgjatë 22 viteve punë, SIGAL UNIQA si grup ka paguar më shumë se 300 milionë euro dëme, shifër kjo që tregon qartë seriozitetin, qëndrueshmërinë financiare dhe përgjegjshmërinë ndaj klientëve të saj.

Vetëm për dy tërmetet e fundvitit 2019, SIGAL UNIQA ka paguar mbi 12 milionë euro dëme për klientët e saj.

Krahas përgjegjshmërisë kontraktuale, SIGAL UNIQA ka dëshmuar përkujdesje maksimale për

komunitetin, duke kontribuar në shëndet, art, kulturë, trashëgimi kulturore, sport, turizëm dhe arsim me miliona euro ndër vite. Vepra të tilla si rikonstruksioni i Teatrit Skampa në Elbasan pas djegies totale, rikonstruksioni i Kinema Millenium Korçë, rikonstruksioni i shtëpisë muze në Korçë e Berat, rikonstruksion shkollash dhe pajisje me mjete shkollore, të gjitha këto mbajnë emrin SIGAL UNIQA.

Sepse e tillë duhet të jetë një kompani, e cila jo vetëm të marrë por edhe duhet ti japë mbrapsh komunitetit, nëpërmjet investimeve në fusha të ndryshme. Kjo ko qenë motoja jonë si SIGAL UNIQA që prej fillimit dhe do të vazhdojë të jetë edhe për të ardhmen. Sepse ne besojmë që zhvillimi jonë shkon krah për krah me zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë.

# Objektivat tona të biznesit 2021–2025

Efektiviteti nga pikëpamja e kostove dhe fitueshmëria 50 milionë euro reduktim të kostove operacionale

Punëdhënësi më tërheqës



Modelet e reja të biznesit - Sanux, Cherrisk

Shitjet 100 milionë Euro

Në fokus 5 tregjet kryesore ndërkombëtare

Pozicioni i 5-të kryesor në sektorin e jo jetës në Poloni, Republikën Çeke, Sllovakia dhe Hungari

Lider i tregut në Austri

Të parët në sigurimin e pasurisë dhe të shëndetit

Ofruesi më i mirë i shërbimeve



# Nismat thelbësore financiare UNIQA 3.0

Nismat themelore financiare

Treguesit e performancës operacionale



Rritje

1. Austria – Lidere e tregut për sigurimi i pronës dhe shëndetit
2. Europa Qendrore dhe Lindore – Të pestët në treg
3. Segmente te reja biznesit – SanusX, CHERRISK

Rritje e primeve 2025: ~3%



Fitime

4. Reduktimi i shpenzimeve për Austrinë & sinergji AXA
5. Rritje e fitimit për sigurimi e pronës
6. Stabilizimi i portofolit - Sigurimi i jetës

Raporti i shpenzimeve totale 2025: ~25%  
Raporti i kombinuar 2025: ~93%  
Kthimi nga kapitali 2025: 8–10%



Cilësi

7. Pozicioni i fortë i aftësisë paguese
8. Dividentë tërheqëse
9. Ulje e debitorëve (raporti i huasë)

Raporti i aftësisë paguese 2025: >170%  
Raporti i pagimit: 50–60%  
Raporti i huasë 2025: <35%

## QENDRA E ASISTENCËS 24/7, FAQE E DEDIKUAR PËR COVID-19 & PËRSHPEJTIMI I PRAKTIKAVE TË DËMEVE



### Qendra e Asistencës 24/7

Për SIGAL UNIQA Group AUSTRIA shëndeti dhe siguria e punonjësve tanë në vijën e parë të shërbimit dhe e klientëve tanë është prioriteti ynë numër një. Pas shpërthimit të pandemisë COVID-19 dhe mbylljeve të detyrueshme ne që të gjithë në këto kohë krizash sfiduese u përballëm me diçka të re, të pabesueshme dhe tronditëse. Kohët e vështira janë gjithmonë kohë ndryshimesh radikale, por edhe një shans për ta ribërë shoqërinë dhe për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA i ka qëndruar gjithmonë pranë njerëzve në kohë krize, duke u mbështetur në solidaritetin, kohezionin, talentin dhe përkushtimin e stafit të kompanisë sonë, që janë bërthama e çdo gjëje që ne bëjmë.

Rrjeti ynë në të gjithë Shqipërinë vazhdoi t'i shërbejë klientëve, bizneseve dhe familjeve me përkujdesin dhe përkushtimin tonë maksimal. Ne i ftuam dhe mundësuam të gjithë klientëve tanë që të përdornin platformën tonë dixhitale të blerjeve online 24/7 për sigurimin e shëndetit, të makinës dhe të shtëpisë.

Gjithashtu Qendra e Asistencës për Klientët

dhe Qendra e Asistencës së Aksidenteve Automobilistike punoi në gatishmëri totale për ofrimin e shërbimeve tona me cilësi dhe me standardin më të lartë për garantimin e sigursë së të gjithëve dhe të asistencës sonë kudo dhe kurdoherë kur ajo nevojitej nga klientët tanë.

Premtimi i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është: për një jetë të shëndetshme, të sigurt dhe të gjatë. Kjo është arsyeja përse shëndeti i shqiptarëve është prioriteti ynë numër një. Këto janë themelet ku shtrihen kompetencat dhe misioni ynë social.

Kjo është arsyeja përse ne jo vetëm që mbrojmë klientët dhe punonjësit tanë me të gjitha mjetet në dispozicionin tonë, por gjithashtu kërkojmë që të mbështesim njerëzit sa më mirë dhe sa më shpejt që të jetë e mundur, me dijet tona në çështjet e shëndetit dhe për përballimin e kushteve aktuale të kësaj "jete/jetese të re". Të gjitha përpjekjet tona ishin në harmonizim të plotë me moton tonë: Qëndroni të Shëndetshëm, Qëndroni të Sigurt, Qëndroni të Motivuar! Në faqen tonë zyrtare në [www.sigal.com](http://www.sigal.com).



al ne përgatitëm dhe vendosëm në dispozicionin e tyre informacione të dobishme, ide dhe sugjerime të shumta.

Shembull i kësaj janë: Blogu ynë <https://sigal.com.al/qendroisigurtneshtepi/>, Klubi i Shëndetit SIGAL <https://www.facebook.com/KlubiShendetitSigal/>, dhe Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL: <https://www.facebook.com/Klubi-i-Artit-dhe-i-Kulturës-SIGAL>, ku ofrojmë informacion për të gjitha gjeneratat se si të përballojnë

kufizimin e lëvizjeve në jetën e re të përditshme, me ushtrime dhe këshilla për promovimin e shëndetit të tyre fizik dhe aftësinë e tyre për t'u përqëndruar.

Për më tepër, ne ishim pranë të gjithë shqiptarve, dhe jo vetëm klientëve të SIGAL UNIQA, nëpërmjet Platofrmës Virtuale të Librave Audio të SIGAL (<https://audiobooks.al>) - e para dhe e vetmja e këtij lloji në Shqipëri, duke ofruar mbi 100 tituj librash në audio (art, kulturë, histori, shkencë, letërsi, përralla dhe poezi) me mbi 50,000 përdorues i aksesueshëm

nëpërmjet SIGAL Audiobooks.al app nga celulari apo kompjuteri për të gjithë shqiptarët kudo ku ata ndodhen dhe kurdo.


### Përshejtimi i Praktikave të Dëmeve

Gjatë muajit prill 2020, SIGAL UNIQA lançoi gjithashtu një Video-mesazh ndërgjegjësues dhe udhëzues mbi praktikën e hapura të dëmeve shëndetësore të shkaktuara nga një aksident automobilistik. Qëllimi i kësaj video ishte ndërgjegjësimi i qytetarëve

në përgjithësi, dhe i klientëve në veçanti mbi praktikën e menjëhershme të dëmshpërblimit, pa burokraci, sa më shpejt që të jetë e mundur, pa ndërmjetësimin e palëve të treta vetëm duke u paraqitur pranë zyrave të SIGAL UNIQA dhe kryerja e menjëhershme e pagesës në bankë pa burokraci, pa humbje kohe dhe pa shpenzuar para ekstra.

### Raportimi i Dëmeve Online

Po gjatë muajit prill 2020, SIGAL UNIQA në kuadër edhe të masave për parandalimin e përhapjes së mëtejshme të COVID-19, i kushtoi një rëndësi të veçantë prezantimit dhe theksit mbi raportimin online të praktikave të dëmeve të shëndetit. Kjo procedurë u aplikua për rimbursimin e medikamenteve / faturave shëndetësore deri në 5,000 lekë, vetëm duke plotësuar numrin e Kartës së Sigurimit Shëndetësor SIGAL; të dhënat personale; të dhënat e ngjarjes dhe direkt online nga shtëpia.



# MEDIA

Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA i ftuar në Euronews Albania të fokusuar mbi "Sigurimin nga Katastrofat Natyrore" për të diskutuar mbi: A duhet të bëhet sigurimi i banesave nga katastrofat natyrore i detyrueshëm?; Kush duhet të paguajë për dëmet në rast katastrofash natyrore ato të 21 shtatorit apo 26 nëntorit 2019?; Shteti nga buxheti i tij me devijimin e taksave të qytetarëve apo sektori privat i sigurimeve në vend? Cili është opsioni më i mirë dhe që garanton mbrojtjen më të sigurt, më të mirë dhe më të plotë financiare? Sa e ekspozuar është gjeografikisht Shqipëria? A është (ri)sigurimi i detyrueshëm vetëm një taksë? Apo një masë për mbrojtjen e pasurisë së të gjithë qytetarëve? Sa janë të mbuluar sot me (ri)sigurim shqiptarët? Çfarë ofron aktualisht tregu ndërkombëtar i risiguruesve – gjerman, zviceran, amerikan, anglez, etj? Çfarë garantojnë ato?

Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA i ftuar në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) të fokusuar mbi "Lançimin e Paketës Anti-COVID-19 nga SIGAL UNIQA", e para dhe e vetmja e këtij lloji në tregun shqiptar të sigurimeve, për të diskutuar mbi: Çfarë përfshin PAKETA ANTI-COVID19? Cilat janë shërbimet, përfitimet dhe shpenzimet mjekësore të ofruara? Sa kushton paketa për një person në vit? Kur duhet blerë? Kur fillojnë efektet financiare të paketës? Si edhe, si mund të aplikoni për ta blerë atë për çdo anëtar të familjes?



Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA i ftuar në ABCNEWS të fokusuar mbi "Sigurimin e Jetës në Kohë Pandemie", për të diskutuar mbi: Ku qëndron shoqëria shqiptare në raport me sigurimin? Cila është gjendja aktuale me këtë situatë tejet të vështirë shëndetësore që po kalojmë? Çfarë mësuam nga përvoja e dy termeteve të fuqishme të vitit 2019? A mjafton vetëm mbulimi që ofron sigurimi shëndetësor shtetëror? Cili do të ishte roli i sigurimeve private në këtë rast? Cili është avantazhi konkurrues i tregut privat të sigurimeve shëndetësore? Si mund të kombinohen së bashku për të plotësuar njëra-tjetrën sigurimi shtetëror me atë privat të shëndetit? A mund të trajtoheni edhe jashtë vendit? Çfarë përfshin specifikisht sigurimi që ka nxjerrë SIGAL UNIQA kundër kësaj pandemie? Si është fluksi i sigurimit të jetës në Shqipëri? Si kanë qenë përfitimet e atyre që e kanë marrë këtë sigurim?

Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA i ftuar në Euronews Albania të fokusuar mbi Jetësimin e "Ligës Unike" ndërmjet Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës, për të diskutuar mbi: Çfarë avantazhesh do t'i sjellë "Liga Unike" basketbollit shqiptar? A do të përfshihet Maqedonia e Veriut në këtë Ligë dhe përse nuk është ajo pjesë që në këtë fazë? Kur do të fillojë së funksionuari "Liga Unike"?

Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA vlerëson me mirënjohje Z. Marin Mema për kontributin, punën dhe hulumtimet e tij të jashtëzakonshme e të paçmuara si gazetar investigativ dhe hulumtues i pavarur, rezultat i disa sondazheve publike të kryera, duke e çmuar Z. Mema për profesionalizmin, integritetin, guximin dhe pasionin e tij.

# PËRGJEGJËSIA SOCIALE

## MBËSHTESIM PROJEKTET SHËNDETËSORE

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA i dhuroi më 5 nëntor 2020, SPITALIT "SHEFQET NDROQI" në Tiranë, një "APARAT RADIOGRAFIK TË LËVIZSHËM", i cili u dorëzua nga Z. Avni PONARI, Drejtor i Përgjithshëm i GRUPIT në përgjigje të menjëhershme të situatës kritike të krijuar nga pandemia COVID-19 në Shqipëri. Ky Spital mban peshën kryesore në trajtimin e kësaj pandemie për të sëmurët me probleme respiratore, si edhe të diagnostikimit, kujdesit dhe trajtimit të COVID-19 në kryeqytet.

## MBËSHTESIM AKTIVITETET SPORTIVE

Fundjavat 3x3 StreetBasket Nën kujdesin e veçantë të Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA dhe në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Basketbollit, u organizuan 5 aktivitete sportive me në fushën e hapur të minibasket të vendosur nga SIGAL UNIQA në Tiranë, Durrës, Elbasan, dhe Korçë.

SIGAL UNIQA 16 vjet me kampionët Jemi shumë të lumtur dhe krenarë që prej 16 vitesh mbështesim kampionët e Prishtinës në Basketboll, "SIGAL Prishtina". SIGAL UNIQA që prej themelimit të saj ka mbështetur sportin, artin e kulturën, këtej dhe përtej trevave. Arti, kultura dhe sporti janë pjesë



Dhurimi i Aparatit Radiografik portativë për Siptain Shefqet Ndroqi

e identitetit kombëtar, janë "ambasadorët" më të mirë për të ngritur imazhin Shqiptar kudo nëpër botë, prandaj dhe ne kemi mbështetur dhe do të vazhdojmë të mbështesim krenarisht këto vlera në trojet Shqipfolëse.

Gjithmonë në mbështetje të Kombëtares KUQ & ZI SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sponsor Zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit!

## MBËSHTESIM TRASHËGIMINË KULTURORE, ARTIN DHE KULTURËN

Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA merr pjesë në pritjen e Samitit të Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA mori pjesë në pritjen e Samitit të Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor, të mbajtur më 27 shkurt 2020, në Tiranë,



Orkestra e Harqeve dhe Zv. Drejtoresha e Përgjithshme Znj Alma Totokoci

e organizuar nga Fondi i Ballkanit Perëndimor me pjesëmarrjen e trupit diplomatik në Tiranë dhe institucioneve të ndryshme në vend.

Orkestra e Harqeve të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA fituese e Edicionit të 5-të të "Takimit Kombëtar të Orkestrave të Harqeve dhe Muzikës së Dhomës" Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA mori pjesë dhe u shpall fituese e Edicionit të 5-të të "Takimit Kombëtar të Orkestrave të Harqeve dhe Muzikës së Dhomës", e mbajtur në Elbasan. Orkestra e Harqeve të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA fituese e Çmimit Ndërkombëtar XHOJA Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA u vlerësua dhe shpall fituese me Çmimin Ndërkombëtar XHOJA.

Me rastin e 100 vjetorit të qytetit të Tiranës - "Vital Truck i SIGAL UNIQA" u shndërrua në "Muzeun Lëvizës" të Bashkisë së Tiranës



Klinika Lëvizëse SIGAL e shëndërruar në Muzeun lëvizës të Tiranës

Në këtë vit të veçantë, jubilar, të 100 vjetorit të Qytetit të Tiranës - "Vital Truck i SIGAL UNIQA", e cila ka shërbyer për të kryer ekzaminime mjekësore falas për qindra mijëra shqiptarë në të gjithë vendin, shndërrohet në "Muzeun Lëvizës" të Bashkisë së Tiranës. Përmes "Vital Truck i SIGAL UNIQA", SIGAL UNIQA Group AUSTRIA mbështet Bashkinë e Tiranës në këtë nismë kaq të veçantë dhe fisnike për të sjellë një flagrancë të Qytetit të Tiranës, në datat 15-20 shtator 2020, në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë etj.

## MBËSHTESIM EDUKIMIN DHE PUNËSIMIN

SIGAL Audiobooks ndryshon raportin me librin në kohë pandemie. Tashmë që prej vitit 2018, SIGAL UNIQA, inicioi dhe ndërmori nismën "Audiobooks.al", projekti i parë dhe i vetëm i këtij lloji në Shqipëri. Kjo nismë synon që, përmes realizimit në versionin audio të librave nga autorë shqiptar dhe të huaj të nxisë edukimin e qytetarëve shqiptarë dhe shqipfolës, brenda dhe jashtë kufijve, për të nxitur dijet dhe për të kontribuar në kultivimin e një gjenerate të re e aftë për të menduar, lexuar dhe dëgjuar në gjuhën teknologjike dhe dixhitale që po udhëheq sot botën. Deri tani, ne e kemi bërë realitet këtë platformë dixhitale të librave audio online ku dëshiron të dëgjojë libra mund të përzgjedhë midis mbi 200 librave të zhanreve të ndryshme nga letërsia klasike, bashkëkohore, historia, shkenca, arti, kultura apo përrallat për fëmijë. Për më tepër, në këtë platformë mund të mësohet më shumë rreth informacioneve dhe produkteve të sigurimit, kushtet e kontratave të sigurimit, si të veprohet në rast dëmi etj. Ju ftojme që të regjistroheni FALAS dhe të dëgjoni pa limit 24/7 nga kudo ku jeni në: [www.audiobooks.al](http://www.audiobooks.al)

# PRODUKTET DHE SHËRBIMET MË GJITHËPËRFSHIRËSE, MË TËRHEQËSE DHE MË NOVATORE

## Shtyllat strategjike

Ne si SIGAL UNIQA po fokusohemi tek standardizimi dhe thjeshtësimi, si edhe tek rritja maksimale e efijencës dhe zhvillimit të targetuar të segmenteve të reja të biznesit për zbatimin e këtyre objektivave ambicioze. Shtyllat tona strategjike të rëndësishme të këtij programi janë:

## Shqipëria dhe rajoni mbeten tregjet tona kyçe

Tregjet gjeografike kyçe të SIGAL UNIQA mbeten Shqipëria dhe më gjerë në rajon – Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Rrjedhimisht, të tria këto vende kanë një rëndësi strategjike shumë të qartë për ne: kjo për shkak të diversifikimit më të gjerë të burimeve tona të fitimit, të cilat përmirësojnë stabilitetin tonë ekonomik dhe na bëjnë më pak të pavarur nga zhvillimet e papritura në tregjet individuale.

## Optimizimi dhe zgjerimi i shërbimeve ndaj klientëve

Tashmë ristrukturimi i grupit i filluar më parë, si edhe riskstrukturimi i imtësishëm

i kostove dhe optimizimi janë bazat për zbatimin e objektivave ambicioze të UNIQA 3.0 – si pjesë e Grupit Ndërkombëtar të Biznesit UNIQA. Këtu, ne kemi përcaktuar një sërë nismash kritike, që përfshijnë tematikë të tilla si proceset, IT-në, të dhënat dhe strukturën tonë organizative, modelet e reja të biznesit, si edhe shifrat tërheqëse financuese kyçe që ne synojmë që të arrijmë. Në Shqipëri, këto programe synojnë sigurimin dhe zgjerimin e pozicionit të fortë të tregut të SIGAL UNIQA, veçanërisht në fushat e sigurimit të shëndetit, fuqizimin e fitueshmërisë në sigurimin e pronës dhe të aksidenteve nëpërmjet reduktimit të kostove administrative, përpunimin eficient të dëmeve dhe përmirësimin në vendosjen e çmimeve, dhe stabilizimin e portofolit nëpërmjet rritjes së fokusit në ruajtjen e kapitalit dhe të produkteve biometrike. Fokus i në rajon mbetet qëndrueshëmria dhe zgjerimi i mëtejshëm i biznesit bazuar mbi themelet solide në të shkuarën dhe prospektet e rritjes pozitive në rajon.

## Akresi dhe shtrirja në tregje të reja: segmentizimi i klientëve

E gjithë struktura jonë organizative po drejtohet drejt fokusit 360 gradë tek klientët tanë. Kompanitë operacionale të Grupit të SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut janë të organizuara sipas segmenteve të klientëve në Shitjet me Pakicë, Sipërmarrjet e Vogla, të Mesme, të Mëdha dhe tregun financiar. Këto reforma të brendshme na mundësojnë që të adresojmë grupet individuale të klientëve nëpër të gjitha linjat e produktit apo familjeve dhe, përveç rritjes së kënaqësisë dhe besnikërisë së klientëve tanë, ne duhet të udhëheqim gjithashtu edhe rritjen e primeve. Një faktor tjetër kyç i suksesit është kultura e korporatës sonë që zbatohet në praktikë, nëpërmjet së cilës SIGAL UNIQA e pozicionon vetveten si një partner motivues dhe frymëzues për klientët, partnerët dhe punonjësit tanë.

# INOVACIONET DHE SHËRBIMET E REJA DIXHITALE ONLINE

## BOTA DIXHITALE E SIGAL UNIQA

### Shërbimet dixhitale më tërheqëse dhe më novatore

UNIQA është mbështetur shumë mbi instrumentet dixhitale për të mbështetur klientët tanë për vite me radhë. Një shembull i kësaj është shërbimi “Telefono Një Mjek”, që mundëson këshillimin mjekësor me një mjek të licencuar 24/7 kudo dhe kurdo. Të sëmureshe dikur do të thoshte të udhëtoje tek zyra e mjekut për t’u ulur në një dhomë pritjeje me individë të tjerë të sëmurë aty rrotull. Pak ose asnjë njeri nuk ka dëshirë të dalë nga shtëpia kur janë të sëmurë, dhe sot falë teknologjisë, shumë njerëz nuk kanë përse ta bëjnë më këtë gjë.

### SIGAL UNIQA App

Nëpërmjet aplikacionit SIGAL UNIQA, të cilën mund ta shkarkoni në ‘App Store’ apo në ‘Play Store’, mund të blihen online produktet dhe shërbimet e sigurimit, të aplikohet online për një procedurë dëmshpërblimi dhe monitorimin në kohë reale të gjendjen e llogarisë së pensionit të Fondit SIGAL online.

BLI ONLINE



# PRODUKTE TË REJA

Si kompani pararojë e novacionit dhe produkteve të reja SIGAL UNIQA ishte e para kompani në Shqipëri që futi në treg produktet e sigurimit të shëndetit në vitin 2007 si dhe themeloi të parin Fond Privat Pensionesh, për t'ju dhënë një mundësi më tepër shqiptarëve për të patur një pension të dytë vullnetar në pleqëri.



## COVID 19

Në betejën e vështirë kundër COVID 19, SIGAL UNIQA dëshmoi edhe një herë që është kompani jo vetëm pararojë e inovacionit duke ideuar dhe hedhur në treg produkte novatore sipas kërkesës dhe nevojës së klientëve por edhe mbështetësja më e madhe e klientëve dhe qytetarëve.

Për t'ju gjendur pranë financiarisht, SIGAL UNIQA, ishte e vetmja kompani që ideoi dhe ofroi klientëve sigurimin Anti-Covid, i cili mbulon shpenzimet për medikamentet, shpenzimet për tamponin dhe shpërbim ditore fiks në rast shtrimi në spital. Qëllimi i këtij sigurimi nuk është që të rezultojë me fitim për kompaninë, por të ndihmojë qytetarët e prekur nga virusi COVID 19, të cilët nuk kanë mundësi të përballojnë kostot financiare të sëmundjes.



## TELEFONO NJE MJEK

Është ky një tjetër shërbim novator i SIGAL UNIQA për klientët, i cili mori një zhvillim të madh gjatë kohës së pandemisë.

Telefono një Mjek, është një shërbim mjekësor online, nëpërmjet të cilit, klientët marrin këshilla mjekësore në çdo orë të ditës apo natës, nga një staf mjekësor i specializuar dhe me eksperiencë.

Nëpërmjet këtij shërbimi, i cili ofrohet nëpërmjet një aplikacioni që instalohet në celularin e çdo klienti, jepet asistencë mjekësore për çdo ankesë apo nevojë që ka secili, madje mund edhe të merren receta online për probleme të ndryshme shëndetësore.

Nuk ka rëndësi se ku ndodhni, mjafton të keni një celular dhe internet dhe mund të komunikoni me mjekun me telefonatë ose video dhe të këshilloheni për problemin tuaj.

Në grupin e mjekëve të këtij shërbimit që ofrohet nga SIGAL UNIQA, ka edhe mjekë pediatër, që do të thotë ju mund të merrni këshilla mjekësore edhe për fëmijët tuaj, nëse e keni blerë këtë shërbim për të gjithë familjen.



## APLIKACIONI SIGAL UNIQA GPS

Tashmë klientët e SIGAL UNIQA, të cilët kanë blerë shërbimin SIGAL GPS, mund ta kontrollojnë automjetin e tyre nga telefoni, shumë thjeshtë dhe shpejt, nëpërmjet aplikacionit më të ri SIGAL UNIQA GPS, i cili mund të shkarkohet nga playstore.

Shërbimi GPS i ofruar nga SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA u mundëson klientëve të shikojnë në çdo moment se ku ndodhet mjeti i tyre, rrugën e përshkruar, shpjeguesin e lëvizjes së mjetit etj.

- Përcaktimi i vendndodhjes së automjetit,

Mjeti/mjetet monitorohen në kohe reale duke përcaktuar edhe shpejtësinë e lëvizjes së tyre

## Kërkimi i MJETIT

Që nga momenti i vendosjes së GPS në mjetin tuaj, në çdo kohë do të keni informacion për:

1. Itinerarin ditor te levizjes se mjetit.
2. Rruga e përshkruar (route)nga mjeti gjatë çdo intervali kohor.
3. Përlllogaritje e sasisë së karburantit të konsumuar për çdo lëvizje.
4. Kohën e qëndrimit ndezur apo fikur.
5. Idle time (koha e qëndrimit ndezur të mjetit pa lëvizur).
6. Kilometrat e përshkruar për çdo ndezje-fikje të mjetit, për një ditë, javë, muaj apo për çdo interval që ju dëshironi.
7. Shpejtësitë e lëvizjes së tij.
8. Geofencing (zonat e lejuara për lëvizjet e mjeteve).



## SIGURIMI "JETË PLUS"

1 në 5 persona diagnostikohen çdo ditë me sëmundje kritike përpara se të arrijë moshën 65 vjeç. Në Shqipëri, 60% e vdekjeve vijnë si pasojë e sëmundjeve të zemrës, ku 40% janë me shkaktar sëmundjet koronare.

Në kohë të tilla, duhet të luftojmë me sëmundjen dhe jo të shqetësohemi ku dhe si ti gjejmë paratë. Prandaj është e rëndësishme që të kesh një partner të sigurtë dhe të fuqishëm financiar, për përballuar të gjitha shpenzimet në rast nevoje.

SIGAL UNIQA Group Austria ka ideuar një produkt të ri sigurimi, "Jetë Plus", i cili ju mundëson të merrni shërbimet mjekësore në spitalet më të mira në botë për sëmundjet serioze.

Me mbulim deri në 1 milion euro në vit ose 2 milionë euro gjatë gjithë jetës, sigurimi "Jetë Plus" ju mbulon shpenzimet për diagnostikimin, konfirmimin e diagnozës dhe trajtimin në spitalet që zgjedh vetë pacienti.

Primi për këtë sigurim është 31,000 lekë për personat e rritur dhe 20,000 lekë/person për të miturit.

Sëmundjet që mbulohen nga sigurimi "Jetë Plus" janë:

- Tumoret Malinje (kancer)
- Ndërhyrjet kirurgjikale në zemër
- Ndërhyrjet kirurgjikale në kokë
- Transplantet nga një dhurues i gjallë



## SIGURIMI "SHËNDET NË UDHËTIM" ME ANULLIM

SIGAL UNIQA ofron për herë të parë Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim me opsionin shtesë për anulimin e udhëtimit.

Me këtë sigurim shtesë, SIGAL UNIQA, do t'ju mbulojë financiarisht nëse ju do të jeni të detyruar që ta anuloni udhëtimin tuaj për SHKAQE TË PAPRITURA dhe TË PAPARASHIKUARA përtej kontrollit tuaj.

Çfarë mbulohet nga opsioni i Anullimit të Udhëtimit?

Rimbursimi i biletës së udhëtimit nga:

- Çdo dëmtim serioz ose gjendje të paparashikuar mjekësore që jua bën juve ose bashkëudhëtarit tuaj të pamundur udhëtimin;
- Në rast fatkeqësie për ju apo një familjar tuajin;

Një detyrim ligjor siç mund të jetë thirrja në gjykatë si dëshmitar.



## SIGURIMI I SHËNDETIT DHE ANTI COVID 19 PËR NXËNËS DHE STUDENTË

SIGAL UNIQA ka hedhur në treg produktin e ri për nxënësit dhe studentët, Sigurimin e Shëndetit & Anti Covid 19, i cili mund të blihet edhe online, përveçse në të gjitha zyrat e SIGAL UNIQA në të gjithë Shqipërinë.

### ÇFARË MBULON?

- Deri në 100,000 lekë/vit shpenzime spitalore
- Deri në 120,000 lekë/vit në rast mjekimi në shtëpi për COVID-19
- Deri në 1,000,000 lekë për sigurimin e jetës së prindit

### SA KUSHTON?


10,000 lekë/vit  
Sigurimi Anti COVID ofrohet edhe për studentët shqiptarë që do të shkojnë të studiojnë jashtë.

# TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON

## SHQIPËRI


### Tregu i sigurimeve jo-jetë

Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 8 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 25.14% të tregut. SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 23.80% të dëmeve.




### Tregu i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 4 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2020 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 53,62% e cila ka paguar 53.68% të dëmeve të ndodhura në treg.



### Tregu i pensioneve private


Gjatë vitit 2020, në tregun e pensioneve operuan 4 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për vlerën e aseteve neto (44%).



## KOSOVË


### Tregu i sigurimeve jo-jetë

Në tregun kosovar operojnë 12 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e para me rreth 12.44% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 12.24% të dëmeve totale të tregut.



### Tregu i sigurimeve të jetës


Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 2 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e dyta me 30.01% të tregut për volumin e primeve dhe ka paguar 32.40% të dëmeve.



## MAQEDONI


### Tregu i sigurimeve jo-jetë

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 11 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e pesta për nga volumi i primeve të shkruara (9.9%).



### Tregu i sigurimeve të jetës


UNIQA Life renditet e katërta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (10.50%) në të cilin operojnë 5 kompani.



# TË DHËNA FINANCIARE


## Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)



Kompania	2017 (në Euro)	2018 (në Euro)	2019 (në Euro)	2020 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	29,664,042	32,247,000	34,899,661	31,429,000
SIGAL Life UNIQA AL	5,476,588	5,314,000	5,884,561	5,050,000
SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA	1,461,529	2,088,000	2,124,432	2,357,000
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	9,559,338	10,509,000	12,034,619	12,204,000
SIGAL Life UNIQA KS	636,650	856,000	1,116,295	1,073,000
UNIQA MK Jo-Jetë	11,345,015	13,054,000	13,384,976	13,450,000
UNIQA Life MK	1,405,624	1,583,000	2,403,932	2,970,000
<b>GRUPI</b>	<b>59,548,838</b>	<b>65,652,000</b>	<b>71,848,476</b>	<b>68,533,000</b>

## Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2020



Lloji i Produktit	AL (në Euro)	KS (në Euro)	MK (në Euro)	Grupi (në Euro)
Pasuri	8,105,566	2,982,226	2,514,829	13,602,621
Motorike	19,836,139	7,467,506	9,605,931	36,909,576
Jetë, Shëndet dhe Aksidente	8,462,170	2,827,685	4,299,418	15,589,274
Pensione Vullnetare*	2,356,654	-	-	2,356,654
Risigurime*	75,272	-	-	75,272
<b>TOTALI</b>	<b>38,835,803</b>	<b>13,277,417</b>	<b>16,420,178</b>	<b>68,533,397</b>

\* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA.

# RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara sipas  
Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar  
per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

# Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Sigal Uniqa Group Austria sh.a,

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Sigal Uniqa Group Austria sh.a (“Grupi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Të konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- Marrim evidencë të mjaftueshme të auditimit të duhur në lidhje me informacionin financiar të njëjësive ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të Grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri  
31 maj 2021

*Kledion Kodra, FCPA*  
*Kodra*





**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	325,060	326,373
Depozita me afat	10	9,552,649	8,403,860
Investime në letra me vlerë	11	1,733,865	1,755,236
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të arkëtueshme të tjera	12	1,321,318	1,490,486
Aktive të risigurimit	13	1,720,138	2,677,421
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	14	751,544	759,715
Inventari		4,689	5,435
Tatim fitimi i arkëtueshëm		110	44,919
Aktive afatgjata materiale	15	1,673,091	1,750,715
Aktive të tjera	16	511,258	305,860
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<b>17,593,722</b>	<b>17,520,020</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrimet për humbje dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	17	5,255,065	5,965,197
Rezervat për primin e pafitur	18	4,324,851	4,297,976
Rezerva të tjera	17	1,700,468	1,484,740
Detyrime të tatimit mbi fitimin		91,855	3,235
Detyrime nga sigurimet dhe risigurimet	19	507,442	686,245
Detyrime të tjera	20	668,849	759,047
<b>TOTAL I DETYRIMEVE</b>		<b>12,548,530</b>	<b>13,196,440</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar	21	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit	21	52,133	52,133
Rezerva të rrezikut të sigurimit	22	693,621	589,996
Rezerva të konvertimit		(159,597)	(195,551)
Rezerva rivlerësimi		136,061	148,688
Fitime të mbartura		2,050,961	1,465,635
<b>Totali i kapitalit që i atribuohet pronarëve të shoqërisë mëmë</b>		<b>5,006,088</b>	<b>4,293,810</b>
Interesi jo-kontrollues		39,104	29,770
<b>TOTALI KAPITALIT</b>		<b>5,045,192</b>	<b>4,323,580</b>
<b>TOTALI KAPITALIT DHE DETYRIMEVE</b>		<b>17,593,722</b>	<b>17,520,020</b>

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë aprovuar nga drejtuesit e grupit më 20 maj 2021 dhe janë firmosur nga:

  
 Avni Ponari  
 Drejtor i Përgjithshëm



  
 Klement Mersini  
 Drejtor Finance

Shënimet nga faqja 5 në 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Prime të shkruara bruto	23	8,183,234	8,573,653
Prime të ceduara në risigurim	24	(1,020,238)	(1,038,232)
<b>Prime bruto të fituara</b>		<b>7,162,996</b>	<b>7,535,421</b>
Ndryshimi në rezervën për prime të papërfituara	18	(54,361)	(439,973)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	13	(41,984)	128,289
<b>Të ardhura neto nga primet</b>		<b>7,066,651</b>	<b>7,223,737</b>
Të ardhura nga investimet		146,358	121,395
Të ardhura të tjera	25	248,258	222,337
		<b>7,461,267</b>	<b>7,567,469</b>
Ndryshimi në rezerva të tjera	18	(209,825)	(188,522)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit në rezervën e dëmeve	18	(221,920)	1,915,906
Dëme dhe shpenzime nga rregullimi i humbjeve	18	(2,440,646)	(5,117,008)
<b>Dëme të sigurimit neto</b>		<b>(2,872,391)</b>	<b>(3,389,624)</b>
Kostot e marrjes në sigurim	26	(1,604,291)	(1,580,366)
Shpenzime administrative dhe marketingu	27	(1,696,561)	(1,868,781)
Shpenzime të tjera sigurimi	28	(448,715)	(534,657)
Fitim nga kurset e këmbimit		22,358	(36,878)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>861,667</b>	<b>157,163</b>
Tatimi mbi fitimin	29	(163,381)	(106,687)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>698,286</b>	<b>50,476</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
<b>Zërat që janë ose mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje</b>			
Të ardhura nga rivlerësimi		(12,626)	148,693
Operacionet e huaja - diferencat në konvertimet në valutë të huaj		35,958	(17,407)
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>		<b>721,618</b>	<b>181,762</b>
<b>Fitimi i atribueshëm për:</b>			
Pronarët e shoqërisë mëmë		688,951	40,649
Interesi jo-kontrollues	8	9,335	9,827
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të atribueshme për:</b>			
Pronarët e shoqërisë mëmë		682,607	171,936
Interesi jo-kontrollues		39,011	9,826

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.****Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Kapitali themeltar	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Rezerva të konvertimit	Rezerva rivlerësimi	Fitime të mbartura	Të atribueshme për pronarët e shoqërisë mëmë	Interesi jo- kontrollues	Totali
<b>Më 1 janar 2019</b>	<b>2,232,909</b>	<b>52,133</b>	<b>581,774</b>	<b>(178,148)</b>	-	<b>1,573,208</b>	<b>4,261,876</b>	<b>19,944</b>	<b>4,281,820</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	40,649	40,649	9,826	50,475
Rivlerësimi i Aktiveve Financiare	-	-	-	-	54,506	-	54,506	5	54,511
Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata	-	-	-	-	94,182	-	94,182	-	94,182
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-	(17,407)	-	-	(17,407)	(6)	(17,413)
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	-	-	-	<b>(17,407)</b>	<b>148,688</b>	<b>40,649</b>	<b>171,930</b>	<b>9,825</b>	<b>181,755</b>
Përvetësimi i fitimeve të mbartura	-	-	8,222	-	-	(8,222)	-	-	-
Dividendi i paguar	-	-	-	-	-	(140,000)	(140,000)	-	(140,000)
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët</b>	-	-	8,222	-	-	(148,222)	(140,000)	-	(140,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>2,232,909</b>	<b>52,133</b>	<b>589,996</b>	<b>(195,555)</b>	<b>148,688</b>	<b>1,465,635</b>	<b>4,293,806</b>	<b>29,769</b>	<b>4,323,575</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	688,951	688,951	9,335	698,286
Rivlerësimi i Aktiveve Financiare	-	-	-	-	(13,157)	-	(13,157)	-	(13,157)
Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata	-	-	-	-	530	-	530	-	530
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-	35,958	-	-	35,958	-	35,958
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	-	-	-	35,958	(12,627)	688,951	712,282	9,335	721,617
Përvetësimi i fitimeve të mbartura	-	-	103,625	-	-	(103,625)	-	-	-
Dividendi i paguar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët</b>	-	-	103,625	-	-	(103,625)	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>2,232,909</b>	<b>52,133</b>	<b>693,621</b>	<b>(159,597)</b>	<b>136,061</b>	<b>2,050,961</b>	<b>5,006,088</b>	<b>39,104</b>	<b>5,045,192</b>

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		861,667	157,163
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin	15	236,237	242,610
Shpenzimi për zhvlerësimin	12	(26,210)	24,761
Humbje nga shitja e aktiveve afat-gjata materiale		95,008	9,043
Të ardhura nga interesi		(146,358)	(121,395)
Efekti i konvertimit		35,955	(17,405)
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>194,632</b>	<b>137,614</b>
<i>Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:</i>			
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme nga sigurimi		195,378	(29,877)
Ndryshimi në kostot e shtyra të marrjes në sigurim		8,171	(41,386)
Ndryshime në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi		957,283	(1,347,479)
Ndryshimi në aktivet e tjera		(204,652)	(62,562)
Ndryshimi në detyrime nga aktiviteti risigures		(7,223)	107,303
Ndryshimi në rezervat për kontratat e sigurimit		(467,529)	2,168,740
Ndryshimi në detyrimet e tjera		(261,778)	(54,675)
Interesa të marra		146,357	121,395
Tatim fitimi i paguar		(29,952)	(92,572)
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>		<b>1,392,354</b>	<b>1,063,664</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitet investuese.</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	15	(253,622)	(280,603)
Shuma të marra/vendosje në depozitat me afat		(1,148,789)	(691,717)
Rënie/(Rritje) e investimeve në letrave me vlerë		8,744	(467)
<b>Flukset neto monetare të përdorura në aktivitetin investues</b>		<b>(1,393,667)</b>	<b>(972,787)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet financuese</b>			
Dividendët e paguar	20	-	(140,000)
<b>Flukset neto monetare të përdorura në aktivitetet financuese</b>		<b>-</b>	<b>(140,000)</b>
<b>(Rënie) neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre</b>			
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit</b>		<b>326,373</b>	<b>375,496</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit</b>	9	<b>325,060</b>	<b>326,373</b>

## RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2020

Në Shoqërinë SIGAL UNIQA Group Austria, Ne si Departament i Auditit, përgjatë gjithë vitit 2020 kemi bërë kontrole të vazhdueshme në të gjithë Departamentet e Kompanisë. Këto kontrole janë bërë konformë planit të punës që ne kemi hartuar në fillim të vitit dhe të miratuar nga ana e Uniqa Group Audit dhe Këshillit Administrativ të Kompanisë. Gjatë vitit ka edhe kontrole të inicuar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Kompanisë për probleme të punës dhe kontrollin e përmirësimit të saj. Shoqëria gjatë vitit 2020, megjithëse ka rënie në realizmin e primeve të sigurimit, kjo si pasojë edhe e ngjarjeve të ndodhura në vendin tonë siç ishin tërmeti i nëntorit të vitit 2019 dhe pandemia e virusit covid-19, përsëri ka arritur që megjithë këto vështirësi të ruajë rolin e liderit në tregun e sigurimeve, të përballojë të gjitha shpenzimet për klientët dhe shoqëritë e siguruar dhe ta mbyllë vitin 2020 me fitim në rezultatin financiar të saj. Më hollësisht për punën e bërë do të paraqesim si më poshtë:

**Departamenti Pasurisë.** Në departamentin e pasurisë është punuar mirë gjatë vitit 2020. Janë plotësuar drejtë e saktë të gjithë rregjistrat e marrjes në sigurim, duke dërguar në kohë të gjitha evidencat e kërkuara si nga Uniqa Group Austria, Autoriteti Mbikqyrës Financiar dhe Statistika në Kompani. Rinovimet e policave shumë vjeçare bëhen sipas afateve të rinovimit si edhe plotësimi i policave të reja. Është punuar në drejtim të plotësimit të planeve të

sigurimit vendosur në fillim të vitit duke u përballur me konkurrencën e fortë në tregun e sigurimeve midis Kompanive të tjera në fushën e sigurimit. Primet e sigurimit janë realizuar më pak se viti 2019 në Shumën 109,692,990 Lekë, ku ndikim të madh patën edhe efektet e covid-19 dhe tërmetit të nëntorit 2019 siç edhe theksuam me sipër. Për secilin produkt sigurimi të ardhurat për Departamentin e Pasurisë janë realizuar si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)
Të Ardhura nga Zjarri	506,665,128
Të Ardhura nga CAR	105,384,658
Të Ardhura nga G. Oferte	5,713,960
Të Ardhura nga G. Kontrate	74,649,865
Të Ardhura nga Bankat	71,620,767
Të Ardhura nga Përgjegjësi	195,019,669
Të Ardhura nga Bujqësi & Blegtori	486,963
<b>Shuma Të Ardhura Pasuria</b>	<b>959,541,010</b>

Siç edhe theksuam për vitin 2020 pati dëme të mëdha në sigurimin e pasurisë si efekt i tërmetit të nëntorit të vitit 2019. Për vitin 2020 në produktin e sigurimit të pasurisë zjarr-tërmet u paguan 726,529,781 Lekë dëme. SIGAL UNIQA Group u gjend pranë klientëve të saj duke bërë të mundur pagesën e të gjithë dëmeve të shkaktuara. Këto dëme zënë rreth 95 përqind të dëmeve të paguara nga departamenti i pasurisë. Dëmet e paguara në mënyrë analitike për departamentin e pasurisë janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Dëme Paguara Sigurime Zjarri	726,529,781	220,689,406
Dëme Paguara Sigurime CAR	10,382,517	16,081,602
Dëme Paguara Sigurime Garanci Oferte	0	0
Dëme Paguara Sigurime Garanci Kontrate	12,049,640	610,647
Dëme Paguara Sigurime Bankat	8,584,689	593,411,196
Dëme Paguara Sigurime Përgjegjësi	3,849,927	2,526,971
Dëme Paguara Sigurime Bujqësi	0	2,616,611
<b>Shuma</b>	<b>761,396,554</b>	<b>835,936,433</b>

Sipas përqindjeve të hartuara dhe miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, është bërë pagesa për komisionet e agjentëve, brokerave në sigurime, bankave me të cilat Kompania ka marrëdhënie etj. Këto komisione zënë mesatarisht rreth 15% të primeve të sigurimit dhe janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)
Komisione Agjenti Sigurime Zjarri	77,188,649
Komisione Agjenti Sigurime CAR	2,597,002
Komisione Agjenti Sigurime Garanci	17,498,127
Komisione Agjenti Sigurime Banka	7,374,056
Komisione Agjenti Sigurime Përgjegjësi	43,837,722
Komisione Agjenti Sigurime Bujqësi	0
<b>Total Komisione</b>	<b>148,495,556</b>

Për të gjitha produktet e sigurimit në departamentin e pasurisë, Kompania është e kujdesshme dhe ka punuar për risigurimin e këtyre kontratave të bëra në mënyrë që në raste rreziqesh të mëdha të bëjë të mundur ecurinë normale të aktivitetit të saj. Kjo gjë u pa fare mirë në rastin e tërmetit të ndodhur në nëntor të vitit 2019, ku nga dëmet e mëdha që u shkaktuan, Kompania kompensoi nga risigurimet e bëra Shumën prej 664,213,104 Lekë ose rreth 90 % të dëmeve të ndodhura në sigurimet nga zjarri-tërmetet. Pagesat për risigurimet që ka bërë Kompania SIGAL UNIQA Group Austria gjatë vitit 2020 për departamentin e pasurisë janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Risigurime Sigurim Zjarri	271,813,625	245,260,831
Risigurime Sigurim CAR	73,177,475	155,118,715
Risigurime Sigurim Garanci Oferte	0	0
Risigurime Sigurim Garanci kontrate	37,782,268	0
Risigurime Sigurim Banka	24,718,388	23,792,275
Risigurime Sigurim Përgjegjësi	63,841,188	105,818,661
Risigurime Sigurim Bujqësi	0	5,805,421
<b>Shuma Risigurime</b>	<b>471,332,944</b>	<b>535,795,903</b>

Duke marrë për bazë të gjithë këto elemente që Ne pasqyruam më sipër, dhe duke vendosur edhe përqindjet e llogaritura në shpërndarjen e shpenzimeve administrative që i përkasin çdo departamenti, për të parë efektivitetin ekonomik-financiar në fund të vitit 2020, nga ana jonë është hartuar një pasqyre përmbledhëse me të gjithë këto elemente si më poshtë:

Analizë Departamenti i Pasurisë (Në Lekë)							
Emërtimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shpenzime Administrative	Shuma Shpenzime	Diferenca
Sigurime Zjarri	506,665,128	726,529,781	271,813,625	77,188,649	146,048,241	1,221,580,296	-714,915,168
Sigurime CAR	105,384,658	10,382,517	73,177,475	2,597,002	30,371,396	116,528,390	-11,143,732
Sigurime Garanc.	80,363,825	12,049,640	37,782,268	17,498,127	23,179,626	90,509,661	-10,145,836
Sigurime Bankat	71,620,767	8,584,689	24,718,388	7,374,056	20,634,846	61,311,979	10,308,788
Sigurime Përgjegj.	195,019,669	3,849,927	63,841,188	43,837,722	56,206,444	167,735,281	27,284,388
Sigurime Bujqësi	486,963	0	0	0	138,303	138,303	348,660
<b>Shuma Pasuria</b>	<b>959,541,010</b>	<b>761,396,554</b>	<b>471,332,944</b>	<b>148,495,556</b>	<b>276,578,856</b>	<b>1,657,803,910</b>	<b>-698,262,900</b>

Në tabelë shihet që shpenzimet e bëra për dëme, risigurime, komisione agjentësh e shpenzime administrative janë më të mëdha se të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit. Kjo në Shumën 698,262,900 lekë. Po të kemi parasysh kompensimet e dëmeve të bëra nga shoqëritë risiguroese në Shumën 664,213,104 Lekë atëherë shuma zbret në 34,049,796 Lekë që ky departament nuk mbulon shpenzimet dhe që duhet të punojë më tepër për rritjen e primeve të sigurimit, uljen e shpenzimeve në mënyrë që të rrisë efektivitetin e tij.

**Departamenti Motorrik.** Edhe në këtë departament është punuar mirë. Organizimi dhe funksionimi i një rrjeti të degëve dhe agjensive në të gjithë territorin, ka bërë që puna në realizimin e produkteve të sigurimit TPL, Kasko, Karton Jeshil dhe Kufitare, Kompania të ruajë rolin e liderit në tregun e sigurimeve. U përballua me sukses nga ana e departamentit pasoja që solli pandemia e covid-19, kjo sidomos për produktin e sigurimit Karton Jeshil, i cili ishte

shitur, por ndërkohë klientët apo firmat e ndryshme të siguruara nuk kishin mundësi të lëviznin për shkak të bllokimit të kufijve. Edhe rregjistrat dhe pasqyrat të domosdoshme për raportimet që bëhen plotësohen në afat dhe sipas formateve të miratuara. Primet e realizuara për vitin 2020 janë me pak 134,845,159 Lekë, por kjo rënie ka qenë fenomen për të gjitha Kompanitë e Sigurimit si shkak i pandemisë dhe SIGAL UNIQA Group ka ruajtur përqindjet në treg. Realizimi i produkteve të sigurimit sipas llojit të tij për Departamentin Motorrik për vitin 2020 është si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)
Të Ardhura nga TPL	1,983,882,611
Të Ardhura nga Kasko	189,904,651
Të Ardhura nga Karton Jeshil	245,828,884
Të Ardhura nga Kufitare	35,436,395
<b>Shuma Të Ardhura Motorrike</b>	<b>2,455,052,541</b>

Dëmet e ndodhura e paguara normalisht shkojnë në raport me realizimin e volumit të primeve të sigurimit, kur situatat gjatë vitit nuk japin fenomene të paparashikuara sidomos me produktin, Karton Jeshil. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe tek SIGAL UNIQA Group Austria, departamenti motorrik, ku dëmet e paguara për këtë departament janë në Shumën 205,741,464 lekë më pak se viti 2019. Për secilin lloj siguri dëmet e paguara për vitin 2020 janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Dëme Paguara Sigurime TPL	411,471,375	658,970,714
Dëme Paguara Sigurime Kasko	143,782,112	112,416,057
Dëme Paguara Sigurime Kartoj Jeshil	96,063,033	78,263,989
Dëme Paguara Sigurime Kufitare	3,700,503	11,107,727
<b>Shuma</b>	<b>655,017,023</b>	<b>860,758,487</b>

Rrjeti i agjentëve të kompanisë është paguar me komisionet për policat e sigurimit të shitura konformë përqindjeve të miratuara për këtë qëllim. Në total shuma e paguar për komisione agjentësh në departamentin motorrik është 430,033,288 Lekë ose e barabartë mesatarisht me rreth 17 % të primeve të sigurimit.

Komisionet e paguara po i paraqesim në pasqyrën më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)
Komisione Agjenti Sigurime TPL	336,611,030
Komisione Agjenti Sigurime Kasko	37,134,321
Komisione Agjenti Sigurime Karton Jeshil	50,648,021
Komisione Agjenti Sigurime Kufitar	5,639,916
<b>Total Komisione</b>	<b>430,033,288</b>

Risigurimet, siç vepohet në çdo departament, janë bërë korrekt për të patur një ecuri normale të punës dhe ulur rreziqet që mund të ndodhin, kjo në departamentin motorrik kryesisht në produktin e sigurimit Karton Jeshil, i cili ka edhe rrisqet më të larta të marrjes në sigurim. Pagesat e bëra për risigurime për vitin 2020 janë sipas pasqyrës më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Risigurime Sigurim TPL	15,339,850	16,701,210
Risigurime Sigurim Kasko	1,664,579	929,764
Risigurime Sigurim Karton Jeshil	49,930,554	34,697,495
Risigurime Sigurim Kufitar	0	0
<b>Shuma Risigurime</b>	<b>66,934,983</b>	<b>52,328,469</b>

Si për departamentin e pasurisë edhe për departamentin motorrik, nga ana jonë duke përpiluar një pasqyrë me treguesit më sipër, duke shtuar ato të përqindjes për ndarjen e shpenzimeve administrative, shohim efektivitetin financiar të tij në tregues të përgjithshëm për vitin 2020. Nga pasqyra shihet që në total departamenti ka efektivitet pozitiv parë nga të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit dhe shpenzimet e bëra. Kjo në Shumën 595,532,417 Lekë. Por një analizë në të gjitha produktet e tij nxjerr që produktet e sigurimit Kasko dhe Karton Jeshil janë me efektivitet negativ. Vëmendja në këto dy produkte sigurimi kryesisht në rritjen e të ardhurave nga primet, por edhe në një ulje të shpenzimeve do të bënte që departamenti të kishte rezultate ekonomike e financiare më të larta për vetë departamentin por dhe Kompaninë në tërësi. Më poshtë është kjo pasqyrë e përgatitur nga ana e jonë.

Analiza Motorrike (Në Lekë)							
Emërtimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shpenzime Administrative	Shuma Shpenzime	Diferenca
Sigurime TPL	1,983,882,611	411,471,375	15,339,850	336,611,030	571,745,559	1,335,167,814	648,714,797
Sigurime Kasko	189,904,651	143,782,112	1,664,579	37,134,321	54,768,696	237,349,708	-47,445,057
Sigurime Karton J.	245,828,884	96,063,033	49,930,554	50,648,021	70,831,350	267,472,958	-21,644,074
Sigurime Kufitare	35,436,395	3,700,503	0	5,639,916	10,189,525	19,529,944	15,906,451
<b>Shuma Motorrike</b>	<b>2,455,052,541</b>	<b>655,017,023</b>	<b>66,934,983</b>	<b>430,033,288</b>	<b>707,535,130</b>	<b>1,859,520,424</b>	<b>595,532,117</b>

**Departamenti Shëndetit.** Departamenti shëndetit operon kryesisht me tre produkte në fushën e sigurimit siç janë shëndeti në udhëtim, shëndeti privat dhe aksidentet personale. Këto janë emërtimet kryesore pasi brenda secilit produkt për klientët ka alternativa të ndryshme. Për vitin 2020 uljen e primeve për shkak të pandemisë së covid-19 në zërin shëndet në udhëtim me pamundësinë për të udhëtuar të klientëve dhe të aksidenteve personale në kufizimin e aktivitetit prodhues të firmave, departamenti e ka kompensuar në një farë mënyrë me rritjen e primeve të sigurimit të shëndetit privat, si për produktet tradicionale por duke dalë edhe me produkte të reja deri edhe për trajtimin nga covid-19 të klientëve. Primet e sigurimit të realizuara për vitin 2020 janë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)
Të Ardhura Sigurime Shëndet në Udhëtim	71,351,416
Të Ardhura Shëndeti Privat	309,085,746
Të Ardhura Aksidentet Personale	41,929,422
<b>Shuma Të Ardhura Shëndeti</b>	<b>422,366,584</b>

Gjatë gjithë vitit 2020 dëmet e ndodhura në departamentin e shëndetit nga Kompania SIGAL UNIQA Group Austria janë paguar rregullisht duke mos sjellë asnjë shqetësim tek klientët e

saj. Pagesat e bëra janë 9,670,141 lekë më pak se viti 2019, ose në kuota normale krahasuar në vite. Për çdo produkt sigurimi dëmet e paguara janë sipas pasqyrës më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Dëme Paguara Sigurime Shëndet në udhëtim	21,072,291	26,576,045
Dëme Paguara Sigurime Shëndet Privat	198,188,135	193,498,215
Dëme Paguara Sigurime Aksidente Personale	11,032,470	19,888,777
<b>Shuma</b>	<b>230,292,896</b>	<b>239,963,037</b>

Pagesat e komisioneve për agjentët e Kompanisë, brokerat etj., janë në Shumën 72,787,469 Lekë ose 17 % e primeve të sigurimit gjë që është brenda kufijeve të miratuar për këto pagesa

Edhe komisionet për agjentët po i paraqesim në pasqyrën më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)
Komisione Agjenti Sigurime Shëndet në Udhëtim	12,635,818
Komisione Agjenti Sigurime Shëndet Privat	49,689,158
Komisione Agjenti Sigurime Aksidente Personale	10,462,493
<b>Total Komisione</b>	<b>72,787,469</b>

Risigurimet në zërat e produkteve të shëndetit janë kryesisht në raste të veçantë për produktin shëndet privat, kur klientë të veçantë sigurohen në shuma të mëdha përfitimi, për produktet e tjera nuk është aplikuar pasi edhe rreziqet mundet të përballohen nga vetë Kompania.

Pagesat për risigurime janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Risigurime Sigurim Shëndet në Udhëtim	162,140	225,576
Risigurime Sigurim Shëndet Privat	7,519,624	7,749,421
Risigurime Sigurim Aksidente Personale	0	0
<b>Shuma Risigurime</b>	<b>7,681,764</b>	<b>7,974,997</b>

Një analizë me të gjitha të dhënat e përmendura më sipër për departamentin e shëndetit, siç edhe kemi përshkruar na tregon se të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit janë më të

vogla se shpenzimet e bëra dhe në total departamenti shëndetit del pa efektivitet. Në analizën e produkteve analitike këtë situatë e sjell sigurimi i shëndetit privat pasi shëndeti në udhëtim dhe aksidentet në vetvete janë me efektivitet. Për këtë duhen marrë masa për këtë produkt sigurimi në rritjen e të ardhurave nga primet e sigurimit, ose parë mundësia e uljes së shpenzimeve, në mënyrë që produkti të dalë me efektivitet dhe po kështu edhe departamenti. Të dhënat e pasqyrës janë si më poshtë:

Analiza Dep. Shëndetit (Në Lekë)							
Emërtimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shpenzime Administrative	Shuma Shpenzime	Diferenca
Sigurime Shëndet U.	71,351,416	21,072,291	162,140	12,635,818	20,566,137	54,436,386	16,915,030
Sigurime Shënd. Privat	309,085,746	198,188,135	7,519,624	49,689,158	89,132,105	344,529,022	-35,443,276
Sigurime Aksidente	41,929,422	11,032,470	0	10,462,493	12,091,281	33,586,244	8,343,178
<b>Shuma Shëndeti</b>	<b>422,366,584</b>	<b>230,292,896</b>	<b>7,681,764</b>	<b>72,787,469</b>	<b>121,789,523</b>	<b>432,551,652</b>	<b>-10,185,068</b>

**Departamenti Marinës.** Ka ulje të ndjeshme të primeve të sigurimit krahasuar me vitin e kaluar. Por kjo ka ardhur si pasojë pasi për vitin 2020 nuk ka patur asnjë sigurim në zërin “Sigurim Avionë” gjë që zë peshë të konsiderueshme në të ardhurat e departamentit. Për vitin 2020 të ardhurat nga departamenti i marinës janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)
Të Ardhura Sigurime Mall në Transport	27,268,404
Të Ardhura Sigurime Anije	16,389,563
Të Ardhura Sigurime Avion	0
<b>Shuma Të Ardhura Marina</b>	<b>43,657,967</b>

Dëmet e paguara gjatë vitit 2020 janë për sigurimet e mallit në transport dhe në shifra të vogla e jo problematike. Janë paguar dëme për vitin 2020 si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Dëme Paguara Sigurime Mall në Transport	3,367,203	2,605,566
Dëme Paguara Sigurime Anije	28,000	171,000
Dëme Paguara Sigurime Avion	0	0
<b>Shuma</b>	<b>3,395,203</b>	<b>2,776,566</b>

Komisionet e agentëve për sigurimet e bëra në departamentin e marinës janë në shumën 8,396,363 Lekë ose rreth 20 % e primeve të sigurimit, shumë e cila është konformë urdhërave e udhëzimeve të lëshuara për këtë qëllim.

Janë paguar komisione agentësh për vitin 2020 si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)
Komisione Agjenti Sigurime Mall në Transport	4,816,896
Komisione Agjenti Sigurime Anije	3,579,467
Komisione Agjenti Sigurime Avion	0
<b>Total Komisione</b>	<b>8,396,363</b>

Risigurimet për departamentin e marinës bëhen rregullisht. Vërejmë se për vitin 2020 risigurimet janë më të larta se viti 2019 pasi shuma e paguar 37,245,215 Lekë për risigurim avionë i përket vitit 2019 dhe paguar në vitin 2020.

Janë paguar risigurime për departamentin e marinës si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Risigurime Sigurim Malli	4,312,244	7,559,269
Risigurime Sigurim Anije	6,223,481	4,532,622
Risigurime Sigurim Avion	37,245,215	30,613,359
<b>Shuma Risigurime</b>	<b>47,780,940</b>	<b>42,705,250</b>

Në analizën e departamentit të marinës lidhur me të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra duhet të theksojmë sa ky departament ka efektivitet në sigurimet që bën, sepse normalisht duhet zbritur risigurimi i bërë për vitin 2019.

Pasqyra e përgatitur për departamentin e marinës është si më poshtë:

Analiza Marinë Aviacion (Në Lekë)							
Emërtimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shpenzime Administrative	Shuma Shpenzime	Diferenca
Sigurime Mall Transport	27,268,404	3,367,203	4,312,244	4,816,896	7,843,561	20,339,904	6,928,500
Sigurime Anije	16,389,563	28,000	6,223,481	3,579,467	4,714,173	14,545,121	1,844,442
Sigurime Avion	0	0	37,245,215	0	0	37,245,215	-37,245,215
<b>Shuma Marinë Aviacion</b>	<b>43,657,967</b>	<b>3,395,203</b>	<b>47,780,940</b>	<b>8,396,363</b>	<b>12,557,734</b>	<b>72,130,240</b>	<b>-28,472,273</b>

Një analizë për të gjithë departamentet së bashku, ku jepet performanca e Kompanisë, nga të dhënat që paraqitëm më sipër na jep një rezultat të tillë për Kompaninë. Të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit janë në shumën 3,889,934,600 Lekë, ndërsa shpenzimet për të gjitha zërat së bashku që kemi paraqitur në pasqyrat më sipër në shumën 4,022,006,226 lekë që në diferencë japin një efekt negativ në shumën 132,071,626 Lekë. Por po të kemi parasysh që dëmet e shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019 janë rimbursuar nga risiguresit në shumën 664,213,104 lekë, atëherë në total Kompania SIGAL UNIQA Group Austria del me efektivitet ekonomik e financiar në shumën 532,141,478 Lekë. Si konkluzion përmendim që duhet të shihen rekomandimet e vendosura për çdo departament, në pasqyrë-analizat e përgatitura si dhe del në pah rëndësia e madhe që kanë risigurimet e duhura dhe korrekte të cilat Kompania i zbaton rregullisht.

**Departamenti Financës.** Në kontrollet në vazhdimësi gjatë vitit, bërë nga ana e jonë, vërejmë se nga ana e departamentit të financës është zbatuar me korrektëse plani unik kontabël i miratuar, dhe po kështu edhe të gjitha standartet ndërkombëtare që aplikohen për financën (SNRF-të). Gjatë vitit 2020 në departamentin e financës është vendosur për herë të parë mbajtja e kontabilitetit në programin financiar SAP, që megjithë vështirësitë e fillimit si



program i ri, në vazhdim po ecën normalisht. Të gjitha llogaritë e prekura me veprime financiare gjatë vitit kanë pozicione të rregullta “debitore” dhe “kreditore” dhe janë të rakorduara me llogaritë analitike korespondente. Ato paraqesin gjendjen reale të Kompanisë më datë 31 dhjetor 2020 në të gjithë treguesit e saj. Bilanci financiar është mbyllur saktë. Paraqitja sintetike e tij me aktivin e llogarive dhe pasivin e tyre është si më poshtë:

<b>Bilanci Sigal 2020</b>	
<b>Aktivi</b>	<b>Viti 2020 (Lekë)</b>
Mjete Monetare në arkë dhe bankë	84,633,054
Depozita me afat në banka	4,456,883,310
Investime në pjesëmarrje	2,223,049,985
Llogari të arkëtueshme të sigurimit	442,361,577
Kosto marrjes në sigurim për tu shpërndarë	349,946,043
Tatim Fitimi për tu marrë	0
Rezerva tek risiguruesit	1,155,633,077
Aktive tjera	257,847,245
Aktive Qëndrueshme Trupëzuara Neto	1,013,592,634
<b>Shuma Aktivi</b>	<b>9,983,946,925</b>
<b>Pasivi</b>	<b>Viti 2020 (Lekë)</b>
Provizjone për primin e pafituar	2,176,934,924
Provizjone për dëmet	2,914,707,828
Tatim Fitimi për tu paguar	74,161,193
Llogari të pagueshme	599,992,327
Provizjone për shpenzime	132,354,961
Kapitali i nënshkruar	2,232,909,184
Rezerva konvertimi	0
Rezerva kapitali	260,495,949
Fitime të mbartura	1,139,008,105
Fitime të vitit	453,382,454
<b>Shuma Pasivi</b>	<b>9,983,946,925</b>

Megjithë vështirësitë e vitit 2020 si pasojë e pandemisë së covid-19, Kompania SIGAL UNIQA Group Austria ka arritur të realizojë për këtë vit një fitim bruto prej 557,720,548 Lekë. Për të paraqitur realizimin e këtij fitimi ne kemi përgatitur pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve

analitike të kompanisë. Elementet analitike të të ardhurave e shpenzimeve financiare për Kompaninë për vitin 2020 janë si më poshtë:

<b>Pasqyra të Ardhura - Shpenzime 2020</b>	<b>Vlera në Lekë</b>
Të Ardhura Prime Sigurimi Pasuria	958,393,577
Të Ardhura Prime Sigurimi Motorrike	2,456,820,584
Të Ardhura Prime Sigurimi Shëndeti	422,323,649
Të Ardhura Prime Sigurimi Marina	43,541,452
Të Ardhura Prime Sigurimi Risigurimi	9,316,198
<b>Shuma Të Ardhura nga Sigurimi</b>	<b>3,890,395,460</b>
Të Ardhura nga Rimbursime Dëme	11,977,582
Të Ardhura nga Qera Shërbime	58,110,187
Të Ardhura të Tjera	1,109,905
Të Ardhura nga Interesat Depozita	18,095,214
Të Ardhura nga Interesat Qeratë	-14,761,094
Të Ardhura nga Diferenca Kursi i Këmbimit	15,103,808
<b>Shuma Të Ardhura Dytësore</b>	<b>89,635,602</b>
<b>Totali Të Ardhura Kompania</b>	<b>3,980,031,062</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>Vlera në Lekë</b>
Amortizimi për ndërtesat	13,139,361
Shpenzime të tjera operative	22,245,491
Humbje nga shitje Asete (Autovetura)	5,818,027
Shpenzime Shitje Produkte	30,017,818
Shpenzime Fond Kompensimi (Pagesa + Provizjone)	124,573,860
Shpenzime shpërblime për agjentët	564,710
Shpenzime Pagat e punonjësve	271,320,816
Shpenzime shpërblimet e punonjësve	12,549,202
Shpenzime shpërblimet e Menaxherët	43,350,423
Shpenzime për personel të jashtëm	703,332
Shpenzime Sigurime Shoqërore	37,893,876
Shpenzime Taksa Lokale	10,202,761
Kontribute për punonjës Fond Pensioni	5,676,000
Shpenzime mirëmbajtje Rrjeti IT	15,903,571
Shpenzime EDP Servicies	471,566
Shpenzime Internet	7,647,902
Shpenzim riparim mirëmbajtje zyra	2,481,058
Shpenzime qera zyra	102,055,070
Shpenzime ujë	808,111

Shpenzime Qeratë (IFRS16)	-107,646,958
Shpenzime energji elektrike	12,315,386
Shpenzime për sigurine	5,769,958
Shpenzime Telefonike	11,206,704
Shpenzime postare	893,192
Shpenzime Administrative	19,285,410
Shpenzime Zyra	12,000
Shpenzime materiale të tjera	1,607,842
Shpenzime Blerje Polica sigurimi	2,135,811
Shpenzime Konsulencë	2,338,726
Shpenzime Konsulencë Auditore	4,966,652
Shpenzime konsulencë Ligjore	1,476,000
Shpenzime Anëtarësimi	9,645,398
Shpenzime kontribute AMF	56,125,740
Shpenzime Pritje Përcjellje	8,477,489
Shpenzime Komisione depozitat	2,040,613
Shpenzime Komisione Bankare	9,138,485
Shpenzime Sigurime	2,134,027
Shpenzime Kamatë vonësa	856
Shpenzime Reklama	106,261,060
Shpenzime Sponsorizime	30,396,775
Shpenzime marketingu kalendarë	960,000
Shpenzime Karburant	19,423,184
Shpenzime Riparime Automjete	7,557,995
Shpenzime Dieta Brenda vendit	482,956
Shpenzime Trajnimi	569,196
Shpenzime Udhëtimi jashtë vendit	1,157,099
Shpenzime Amortizimi Automjete	14,483,237
Shpenzime Amortizimi IT	11,676,981
Shpenzime Amortizimi Mobilje	4,434,957
Shpenzime Amortizimi Pajisje	6,929,246
Shpenzime Amortizimi Aktive jo trupëzuara	3,805,323
Shpenzime Amortizimi Asete (IFRS16)	97,048,782
Shpenzime Provigjone (Debitore pa arkëtuar)	35,914,493
Shpenzime Gjqësore - Noteriale	9,285,007
Shpenzime Taksa Të Tjera	6,858,107
Gjoha Kamate Vonesa	74,103
Shpenzime Menaxhimi	14,561,469
Shuma	1,121,226,255
Shpenzime Paguar Risigurim	599,151,957
Rezervat për primine pafituar	14,801,257

Shpenzime Dëme Paguara	1,649,361,578
Dëme Paguara Risiguresit	-664,213,104
Ndryshimi Rezerva për dëmet	55,363,418
Shpenzime Komisione Agjenti	646,619,154
<b>Shuma</b>	<b>2,301,084,260</b>
<b>Total Shpenzimet</b>	<b>3,422,310,515</b>
<b>Fitimi Bruto</b>	<b>557,720,547</b>

Kapitali i nënshkruar me lëvizjet e tij për kompaninë është në nivele stabël. Ndryshimet e tij vijnë kryesisht nga fitimet e realizuara në vite apo edhe rastet kur është vendosur shpërndarje fitimi në formën e dividendit. Ndryshimet në kapital për vitin 2020 janë sipas pasqyrës më poshtë:

Pasqyra e ndryshimeve në kapital 2020 (Në Lekë)					
	Kapital nënshkruar	Fitime Mbartura	Rezerva Tjera	Rezerva konvertimi	Totali
Gjendja 1/1/2020	2,232,909,184	1,139,008,105	262,224,726	-1,728,777	3,632,413,238
Transferim Rez. Të tjera	0	0	-1,728,777	1,728,777	0
Fitimi i Vitit 2020	0	453,382,454	0	0	453,382,454
Gjendja 31/12/2020	2,232,909,184	1,592,390,559	260,495,949	0	4,085,795,692

Kompania ka një gjendje monetare të qëndrueshme, në rritje nga viti 2019. Mjetet e saj monetare janë në depozita bankare, të shpërndara thuajse në të gjitha bankat e nivelit të dytë me të cilat Kompania edhe bashkëpunon në fushën e sigurimeve. Për të paraqitur gjendjen e mjeteve monetare në llogaritë e saj bankare dhe në depozita në fund të vitit 2020 nga ana jonë është përgatitur pasqyra më poshtë:

Mjete Monetare në Arkë dhe Bankë	Viti 2020 (Në Lekë)
Mjete Monetare në Arkë	2,852,682
Mjete monetare Bankë Lekë	43,432,601
Mjete monetare Bankë Euro	32,765,600
Mjete monetare Bankë Usd	5,582,171
<b>Shuma</b>	<b>84,633,054</b>

	Viti 2020
Depozitat me afat në Banka	
Depozita bankare në Lekë	955,000,000
Depozita bankare në Euro	2,908,519,795
Depozita bankare në Usd	586,888,800
<b>Shuma</b>	<b>4,450,408,595</b>
Interesa të përlogaritur Viti	6,474,715
<b>Totali</b>	<b>4,456,883,310</b>
<b>Gjithsej Mjete Monetare</b>	<b>4,541,516,364</b>

Gjendjet në llogaritë bankare dhe depozita sipas bankave të nivelit të dytë me të cilat Kompania SIGAL UNIQA Group Austria punon për vitin 2020 janë sipas pasqyrës më poshtë:

Mjete Monetare 2020 (Në Lekë)		
Emërtimi	Mjete Llogari	Depozita
BKT	12,781,000	1,481,615,000
ISP	4,805,000	235,496,000
RFZ	10,832,000	34,286,000
Credins	1,959,000	678,464,000
ABI	16,950,000	817,252,000
OTP	9,084,000	555,978,000
Procredit	3,455,000	178,123,000
T. Bank	4,896,000	403,262,000
UBA	3,692,000	0
Alpha bank	7,434,000	10,000,000
Union bank	4,231,000	55,933,000
FIB	1,661,000	0
<b>Shuma</b>	<b>81,780,000</b>	<b>4,450,409,000</b>

Kompania ka bërë investime gjatë viteve në krijimin e filialeve të saj në SIGAL Kosovë dhe UNIQA Maqedonia e Veriut, po kështu në SIGAL Life Shqipëri, Kosovë dhe Maqedonia e Veriut. Këto Shuma nuk kanë ndryshime nga viti 2019 dhe në fund të vitit 2020 paraqiten si më poshtë:

Investimet në Pjesëmarrje	Viti 2020 (Në Lekë)	Viti 2019 (Në Lekë)
Investime në Kompaninë SIGAL Kosovë	554,409,000	554,409,000
Investime ne Kompanine SIGAL Life Kosovë	491,727,510	491,727,510
Investime ne Kompanine Uniqa Maqedoni V	318,874,475	318,874,475

Investime ne Kompanine Uniqa Life maqedoni V	488,040,000	488,040,000
Investime ne Kompanine SIGAL Life Shqiperi	369,999,000	369,999,000
<b>Shuma</b>	<b>2,223,049,985</b>	<b>2,223,049,985</b>

Shtesat e paksimet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara janë rregjistruar drejtë e saktë. Edhe llogaritja e amortizimit vjetor të aktiveve është bërë brenda normave të miratuara për secilin lloj të aktivitetit të trupëzuar dhe patrupëzuar dhe gjendja në fund rakordon me listat analitike të tyre. Lëvizjet e aktiveve qëndrueshme trupëzuara me gjendjet e tyre në fillim të vitit, lëvizjet gjatë vitit dhe gjendjet në fund të vitit bruto dhe neto, së bashku me amortizimin, janë si pasqyra më poshtë:

Lëvizjet për Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara (Në Lekë)	Toka	Ndërtesa	Automjete	Pajisje Zyre It	Përmirësim objekte Qera	Totali
Gjendja 01/01/2020	82,853,272	806,586,901	181,643,074	371,987,814	38,053,230	1,481,124,291
Shtesa gjatë vitit	0	3,031,588	20,451,867	28,068,661	0	51,552,116
Pakësime gjatë vitit	0	0	25,345,789	0	0	25,345,789
Gjendja 31/12/2020	82,853,272	809,618,489	176,749,152	400,056,475	38,053,230	1,507,330,618
AMORTIZIMI						
Gjendja 01/01/2020	0	282,228,435	109,048,506	282,518,748	21,671,59	695,467,283
Amortizimi i vitit	0	13,139,360	14,483,237	23,041,184	3,805,323	54,469,104
Pakësime	0	0	6,555,760	0	0	6,555,760
